



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
"Teknologji Informacioni"
Universiteti Privat "Albanian University"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Eris Zeqo

Prof.Asc.Endri Raço

Korrik / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 33, datë 31.01.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati nr. 09, dt. 07.04.2021 Miratuar nga MAS me shkresë nr. 2600/1, dt. 02.06.2021
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA. 397, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim të BA Nr.82, dt. 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ETC
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE / PAK për programin e studimit:	5 PAE / 3 PAK (2022-2023) Ngarkesa në orë: (69.45% / 30.55%)
18	Numri i studentëve:	2021-2022 30 studentë; 2022-2023 23 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Albanian University është një institucion arsimor privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë në Shqipëri. Ai u licencua për herë të parë në Prill të vitit 2004 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, duke filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2004-2005 me Degën e Stomatologjisë si dega e parë, duke pritur rreth njëqind studentë në kursin e parë të studimeve.

Me kalimin e kohës, universiteti ka pasur një rritje të vazhdueshme dhe konsolidim në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë hapjen e programeve të reja studimi dhe rritjen e numrit të studentëve. Ai vazhdon të mbetet një institucion i rëndësishëm në Shqipëri, duke ofruar një gamë të gjerë programesh studimi dhe duke kontribuar në formimin e brezit të ri të profesionalëve të kualifikuar për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar. Pjesa akademike e Albanian University përfshin tre fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;
2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është një ndër pjesët themelore të këtij institucioni dhe përmban Departamentin e Inxhinierive, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni". Ky program ofrohet në kuadër të ciklit të dytë të studimeve universitare dhe është licencuar nga ministria e arsimit. Ky program studimi është licensuar sipas Urdhërit të MASH Nr.33, datë 31.01.2012, si program i ciklit të dytë realizuar me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në formën e studimit me kohë të plotë. Programi është riorganizuar deri në 20% me Vendim Senati nr. 09, dt. 07.04.2021 dhe miratuar nga MAS me shkresë nr. 2600/1 prot, datë. 02.06.2021. Sipas VBA Nr. 82, datë 27.10.2018 është akredituar ky program studimi me kohëzgjatje 5 vite akademike. Programi i studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është një program studimi që synon të ofrojë njohuri të thella dhe të avancuara shkencore dhe profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi përfshin mësimdhënie dhe hulumtime bazuar në metodat dhe instrumentet më të fundit teknologjike dhe thekson përvetësimin e këtyre aftësive përmes një qasjeje metodologjike dhe aplikative. Programi synon gjithashtu të përgatitë studentët për të vazhduar studimet e tyre në nivele më të larta, si doktoratura, dhe përfshin të gjitha komponentët e nevojshëm për pranim në nivelin e tretë të studimeve. Ai mbështetet në përvojën disavjeçare të praktikës dhe standardet evropiane dhe synon të sigurojë një tranzicion të shpejtë në tregun e punës. Përveç kësaj, programi synon të krijojë bazat e nevojshme për studentet e interesuar në thellimin e studimeve më të profilizuara duke përfituar kështu kompetenca më specifike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109/2017, Autoriteti i Sigurimit të Cilësisë në Arsimit të Lartë (ASCAL) ka caktuar kohën dhe grupet për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”. Bazuar në Urdhër nr. 124, datë 10.10.2023, me numër protokoll 140/3 të Autoritetit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimit të Lartë (ASCAL), për përcaktimin e ekspertëve të përfshirë në vlerësimin e jashtëm për procesin e akreditimit të programeve të studimit, aplikuar nga Albanian University, grupi i vlerësimit përbëhet nga: Prof. Asc. Endri Raço dhe Dr. Eris Zeqo. Gjatë të gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, grupi ka pasur asistencë nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Tetor 2023, ka qenë burimi kryesor i informacionit për grupin e punës. Ky raport ka ofruar një analizë të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave të përdorura nga Albanian University për të arritur objektivat dhe për të menaxhuar efikasitetin e proceseve të cilësisë dhe standardeve. Përveç kësaj, Albanian University ka furnizuar një numër dokumentesh mbështetëse përmes sistemit të menaxhimit të cilësisë të ofruar nga ASCAL. Për kryerjen e këtij vlerësimi, Grupi i Vlerësimit Jashtëm (GVJ) është mbështetur kryesisht në kërkesat e përcaktuara nga ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet nënligjore që dalin nga ky ligj. Këto aktet përfshijnë VKM-në Nr. 531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM-në Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe ndryshimet dhe shtesat në VKM-në Nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM-në Nr. 185, datë 25.3.2021, të cilat janë bërë në vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Takimet në institucion, u zhvilluan në dy ditë sipas programit të miratuar nga ASCAL në datat 18.12.2023 dhe 19.02.2023. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive midis përfaqësuesve të institucionit dhe grupit të vlerësimit të jashtëm, dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierive, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentit, përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike, përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u përqendrua në analizën e thelluar të strukturës së programit, duke shqyrtuar me kujdes syllabusin, vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat e synuara për t’u fituar, metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe literaturën bazë dhe shtesë të përdorur në program. Gjithashtu, u konsideruan mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimi i kredive akademike, cilësitë e stafit akademik, dhe aspekte të tjera të rëndësishme të programit. Të dhënat dhe informacioni në raport janë bazuar në burime dokumentare të përmendura më lart, në të dhënat e mbledhura gjatë

takimeve, si dhe në materiale shitesë të ofruara nga institucioni, sipas kërkesave të paraqitura nga GVJ-ja. Në përfundim të raportit, ekspertët kanë hartuar një sërë rekomandimesh për të përmirësuar programin e studimit, duke adresuar pikat e identifikuara si të forta dhe të dobëta, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të programit.

Universiteti Privat "Albanian University", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.05.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 177 / 11 Prot, datë 31.05.2024. Universiteti Privat "Albanian University", njofton në ASCAL më datë 07.06.2024, me anë të shkresës me Nr.193/1 Prot, datë 07.06.2024 "Kthim përgjigje shkresës me Nr. 177 / 11 Prot, datë 31.05.2024", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimi i Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.82, datë 27.10.2018 është:

1. Institucioni brenda vitit akademik 2018 – 2019, të rekrutojë staf të ri akademik me kohë të plotë, me grada dhe tituj me qëllim uljen e ngarkesës së lartë mësimore dhe numrit të lëndëve të mbuluara nga stafi akademik aktual i angazhuar në këtë program studimi;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Rekomandimi për shtimin e personelit akademik me kohë të plotë të kategorisë lektor ose profesor **nuk është plotësuar**. Njësia bazë Departamenti i Inxhinierive në përfundim të vitit akademik 2022-2023 (1 profesor dhe 7 lektorë) ka të njëjtin numër personeli akademik me kohë të plotë me grada shkencore dhe tituj akademik krahasuar me vitin akademik 2018-2019 (8 lektorë). Në nivel njësie kryesore, numri i personelit akademik me kohë të plotë me grada shkencore / tituj akademik është zvogëluar brenda të njëjtës periudhë nga 26 në 20 (tabelë përmbledhëse 1).

Kjo problematikë pasqyrohet edhe në analizat vjetore të vetë njësisë bazë (evidencë 1.1) dhe kjo situatë nuk ka përmirësuar problematikën e ngarkesës së lartë mësimore për

të mbuluara prej tyre brenda një semestri apo viti akademik (tabelë përmbledhëse 4). Duke konsideruar rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në vitet e fundit akademike sidomos në programin e ciklit të parë bachelor në "Teknologji Informacioni" dhe shtimin e leksioneve (ngarkesës mësimore) që lektorët e aktivizuar në këtë program studimi mbulojnë edhe në programet e tjera të studimit, kjo situatë mund të bëhet edhe më problematike nëse nuk merren masat e rekomanduara.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Teknologji Informativë"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV) dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, Grupi Vlerësues i Jashtëm (GVJ) konkludon se programi i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH) në "Teknologji Informativë", i ofruar nga Departamenti i Inxhinierive në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, përmbush të gjitha komponentët e nevojshme dhe ndihmon në promovimin e interesave kombëtare. Ky program, si një program bashkëkohor dhe koherent, ndihmon në përgatitjen dhe kualifikimin e studentëve për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit. Po ashtu, vlerësohet se programi i studimit është në përputhje me misionin dhe strategjinë e Albanian University, si dhe me strategjinë kombëtare të zhvillimit të teknologjisë së informacionit. (Evidenca 1.4.a) Vlerësimi i GVJ-së është mbështetur në evidencat dhe dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit, si dhe në gjithë informacionin e grumbulluar gjatë vizitës në institucion.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar RVB, Departamenti i Inxhinierisë në universitet ofron një gamë të gjerë programesh studimore që përfshijnë nivelet Bachelor, Master dhe Master Profesional. Këto programe janë hartuar me një orientim strategjik dhe përputhen plotësisht me vizionin dhe misionin e institucionit. (Evidenca 1.1.a-e), (Evidenca 1.2), (Evidenca 1.3)
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV), Grupi Vlerësues i Jashtëm (GVJ) konkludon se procesi edukativ dhe metodologjik i Departamentit të Inxhinierisë përfshin synime për zhvillimin institucional, si dhe planifikimin dhe

Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	zbatimin e masave që synojnë të përmbushin objektivat strategjike të institucionit. (Evidenca 1.4.a-e), (Evidenca 1.4.b)			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Grupi Vlerësues i Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimeve Master i Shkencave në Teknologji Informacioni është i projektuar për të mbështetur studentët me një edukim të orientuar drejt praktikave dhe standardeve europiane, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive të nevojshme për të përballuar sfidat aktuale dhe të ardhshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi përcakton një rrugë qartë për avancimin profesional dhe akademik, përfshirë kriteret të detajuara për transferimin e krediteve dhe procedurat për diplomimin, në përputhje me kërkesat e njohjes së arsimit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht. (Evidenca H1)			
Konkluzione	<i>Programi i studimit, Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" ofrohet në Universitetin Privat "Albanian University", në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e IAL, njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Grupi Vlerësues i Jashtëm (GVJ) konstaton se Departamenti i Inxhinierisë disponon kapacitetet e duhura njerëzore dhe infrastrukturore (Evidenca 1.5) për të ofruar programin e studimit për nivelin Master në fushën e "Teknologjisë Informacionit". Ky program avancuar ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, i cili përfshin disiplina akademike dhe hulumtuese në sferat e ekonomisë dhe inxhinierisë së dizajnit.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 81 pedagogë, nga të cilët 39 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 38 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	5
Prof.Asoc	3	9
Dr/PhD	16	22
Msc	19	6
Gjithsej	39	42

Ndërsa Departamenti i Inxhinierive, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Inxhinierive	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	1
Prof.Asoc	1	4
Dr/PhD	7	12
Msc	10	1
Gjithsej	18	18

(Evidenca 5)

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Nga takimet me stafin e Departamentit, Grupi Vlerësues i Jashtëm (GVJ) konstaton se institucioni ka angazhuar burimet e veta për të përmbushur kërkesat e Udhëzimit nr. 31, të datës 15 janar 2022, që përcakton kodifikimin dhe standardizimin e programeve të studimit. Përgjegjësit e programit janë të përkushtuar për të zbatuar këto kritere dhe për të siguruar që të gjitha procedurat për zhvillimin dhe ofrimin e programit të përmbushin afatet e përcaktuara dhe të jenë në përputhje me direktivat e arsimit të lartë në Shqipëri.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Grupi Vlerësues i Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në

e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>"Teknologji Informacioni" është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit (Evidenca 1.2) (Evidenca 1.4.a).</p> <p>Po ashtu, ai përmbush politikat e zhvillimit të institucionit në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit.</p>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N / A			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe nga takimet me stafin e Departamentit, GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierive ka bashkëpunime me institucione të ndryshme, vendase dhe të huaja, publike dhe private (Evidenca 5.2), (Tabela 5 - RVB). Nisur nga RVB, institucioni i arsimit të lartë shpreh gadishmërinë të ofrojë trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave ofrohet në Universitetin Privat "Albanian University", është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit

të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Përcaktimi i ndarjes së detyrave midis departamenteve dhe stafit të institucionit ndiqet në bazë të rregulloreve të vendosura nga institucioni dhe ato të departamentit përkatës. Sipas vlerësimit të kryer, Departamenti i Inxhinierive administron me efikasitet programin dy-vjeçar të Masterit Shkencor në “Teknologji Informativ”, i cili përbëhet nga 120 kredite. Gjithashtu, konstatohet një bashkërendim të frytshëm dhe të ngushtë me të gjithë segmentet përkatëse të institucionit, përfshirë Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretarinë mësimore, Arkivën, protokollin, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra për zhvillimin e kurrikulave, Zyra për Studentë dhe Këshillimin e Karrierës etj. Ky nivel bashkëpunimi kontribuon në përmirësimin e efektivitetit të programit studimor në fjalë dhe ndikon pozitivisht në rolin e Departamentit Inxhinierive.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në Dosjen e Vetëvlerësimit dhe në përfundimet e takimit me përfaqësues të institucionit, vlerëson pozitivisht se Albanian University, e posaçërisht Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ka arritur të nënshkruajë dhe zbatuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme akademike, subjekte ekonomike private dhe organet shtetërore (siç shënohet në Evidencën 1.1.e). Gjatë diskutimeve me studentët, si dhe me personelin akademik, të angazhuar si në mënyrë të plotë ashtu edhe të pjesshme, u theksua se universiteti ka zhvilluar bashkëpunime të shumta me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) vendase dhe ndërkombëtare, si dhe me entitete të sektorit privat. Një tjetër pikë e vlerësuar lart është rritja e interesit dhe pjesëmarrjes aktive në iniciativa ndërkombëtare, si programi Erasmus+, që tregon një orientim drejt internacionalizimit dhe rritjes së angazhimit ndërkombëtar të institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, për realizimin e programit të studimit, institucioni ka nënshkruar 30 marrëveshje të posaçme me kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. (Evidenca 1.1.e)</p>

<p>kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike (një herë në vit), Departamenti i Inxhinierive harton raport analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. (Evidenca 1.7.b)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Inxhinierisë në universitet zbaton me sukses programe të studimit të orientuara drejt efikasitetit dhe bashkëpunimit strategjik. Përmes ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësisë, departamenti siguron marrëdhënie të shkëlqyera brenda institucionit, duke kontribuar në administrimin efektiv të programeve të tij akademike, si programi dy-vjeçar i Masterit Shkencor në "Teknologji Informacioni". Institucioni vazhdimisht bashkëpunon me njësi të ndryshme si Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra për Zhvillimin e Kurrikulave, duke garantuar një performancë të lartë akademike dhe përmirësim të vazhdueshëm.</i></p> <p><i>Në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe zhvillimit profesional, universiteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte ekonomike, si dhe është pjesë e iniciativave ndërkombëtare si programi Erasmus+. Këto veprime sinjalizojnë një përkushtim të qartë ndaj rritjes së angazhimit ndërkombëtar dhe ofrimit të mundësive të shumta për studentët dhe stafin akademik.</i></p>

	<i>Përveç kësaj, Departamenti i Inxhinierisë harton në mënyrë periodike raporte analitike për të vlerësuar përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe për të siguruar që programet e studimit të realizohen me sukses dhe të mbështeten nga praktika profesionale relevante, duke ndikuar kështu në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është strukturuar në mënyrë që të integrojë një numër të caktuar të moduleve, të cilat janë të vlerësuara në kredite bazuar në Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, i njohur si ECTS. Çdo student duhet të përfundojë një total prej 60 kreditesh çdo vit akademik për të arritur kërkesat e programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në	Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" synon të japë studentëve një bazë të thelluar dhe të avancuar në dijet shkencore dhe profesionale në fushën e teknologjisë së

<p>larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>informacionit. Kjo arrihet përmes përdorimit të metodave dhe instrumenteve më të fundit dhe inovative, duke u fokusuar në zhvillimin dhe përvetësimin e njohurive që janë të nevojshme për sfidat në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi u ofron atyre që kanë mbaruar studimet Bachelor në fushën e Inxhinierisë, njohuri të mjaftueshme dhe të detajuara që do t'u lejojnë të vazhdojnë në programin e Masterit me një kuptim të thelluar të aplikimit metodologjik, si dhe të zhvillojnë aftësi që janë esenciale për të adresuar problemet komplekse në fushën e tyre të studimit. Studentët do të mësojnë të projektojnë dhe të zhvillojnë sisteme të informacionit dhe të kontribuojnë në progresin shkencor dhe teknologjik në industrinë e teknologjisë së informacionit. Programi gjithashtu lejon dhe inkurajon studentët që të zgjerojnë njohuritë e tyre për të kryer hulumtime shkencore që janë bazat për studime të mëtejshme, si doktoraturat, dhe përfshin të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e një karriere akademike dhe profesionale, siç janë hulumtimi dhe aftësitë për të kryer kërkime origjinale.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga dokumentacioni i disponuar (Evidenca 2.1.a), (Evidenca H1), përcaktohet qartë ngarkesa në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Sipas rregullores, programi i studimit është strukturuar në mënyrë që çdo element i kurrikulës të jetë i përshkruar me detaje, duke përfshirë kredite që caktohen për çdo lëndë mësimore dhe aktivitet, si praktika profesionale dhe puna e kursit për përmbylljen e programit.</p> <p>Praktika profesionale në këtë program ka një peshë specifike në kredite totale dhe është e integruar në mënyrë të plotë me objektivat e mësimdhënies dhe qëllimet afatgjata të programit. Praktika profesionale, si dhe detyrimet e tjera përmbyllëse, jo vetëm që përcaktohen në kredite, por ato janë projektuar për të siguruar një përvojë të drejtpërdrejtë dhe të aplikueshme në fushën e teknologjisë së informacionit, duke u siguruar studentëve aftësitë praktike që kërkohen në tregun e punës. Në mënyrë specifike, dokumentacioni të cilin grupi ka pasur në dispozicion, specifikon se kreditet për praktikën profesionale dhe për detyrimet përmbyllëse janë një pjesë thelbësore e strukturës së krediteve të programit, dhe ato janë të inkuorpuara që në fazën e planifikimit të programit për të garantuar që</p>

	studentët marrin njohuritë dhe përvojën praktike të nevojshme për të qenë konkurrues në fushën e tyre.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	Albanian University nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë

kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në mbështetje të dokumentacionit në dispozicion, Departamenti i Inxhinierive ofron 2 programe studimi Master i Shkencave dhe 1 program studimi Master Profesional. Lëndët dhe formimi në tërësi i programit të studimit, të ciklit të dytë Master, është në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimi dhe i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera që ofrojnë programe në të njëjtën fushë studimi. Programet kanë specifika të veçanta por përmbajtje të ngjashme në nivel mbi 70 për qind. (Evidenca 1.1.a); (Evidenca 1.1.b); (Evidenca 1.1.c); (Evidenca 1.1.d); (Evidenca 1.1.c);
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar RVB – së, në përputhje me Udhëzimin MAS Nr.31, date 15.11.2022 kodifikimi është në proces.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” nuk ofrohet si program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Konkluzione	<i>Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është projektuar me qëllimin për të ofruar një edukim të thelluar në fushën e teknologjisë së informacionit, duke përshtatur metodat dhe instrumentet më të fundit dhe inovative për të zhvilluar njohuri të avancuara shkencore dhe profesionale. Programi synon të zgjerojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve për të adresuar sfidat komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar, përmes një qasjeje metodologjike që</i>

	<p><i>lejon përvetësimin e aftësive praktike dhe teorike esenciale për industrinë.</i></p> <p><i>Struktura e programit është e qartë dhe përputhet me kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ku çdo student duhet të përfundojë 60 kredite çdo vit akademik. Programi gjithashtu përmbush nevojat për praktikë profesionale dhe detyrime përmbyllëse, të cilat janë integruar plotësisht në kurrikulën akademike dhe janë të nevojshme për përgatitjen e studentëve për tregun e punës.</i></p> <p><i>Përgjithësisht, programi i studimit në "Teknologji Informacioni" mbulon të gjitha aspektet e nevojshme për një karrierë të suksesshme akademike dhe profesionale, duke përfshirë hulumtimin shkencor dhe aftësinë për të kryer kërkime origjinale, të cilat janë thelbësore për ato që synojnë një avancim në fushën e teknologjisë së informacionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Inxhinierive pranë AU janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Njësia kryesore (FSHAE) është e përbërë nga 3 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Art Dizajn; 2. Departamenti i Inxhinierive; 3. Departamenti i Shkencave Ekonomike; <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 81 pedagogë, nga të cilët 39 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 42 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p>

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	5
Prof.Asoc	3	9
Dr/PhD	16	22
Msc	19	6
Gjithsej	39	42

Departamenti i Inxhinierive përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	2	-	2	-	1
Prof. Asoc.	-	5	1	5	1	4
Dr./PhD.	7	7	7	11	7	12
Msc.	8	3	9	1	10	1
Totali	15	17	17	19	18	18

Evidenca 5

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar në RVB, Realizimi i praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj zhvillohet nën mbikqyrjen e një pedagogu të caktuar nga Departamenti i Inxhinierive, i cili është përgjegjës për jo më shumë se 20 studentë.</p> <p>(Evidenca H1) (Evidenca 2.2)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive, në përputhje me objektivat e tij për realizimin me sukses të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” ka të përcaktuar objektivat e Koordinatorit të Programit të studimit. Roli i tij është i</p>

person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë (Evidenca 2.3), (Evidenca 2.4.a), (Evidenca 2.4.b). Koordinatori për programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” është caktuar konform Rregullores së Programit të studimit.			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në përgjithësi dhe Departamenti i Inxhinierive në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierive disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren e programit mësimor (Evidenca H1), syllabuset (Evidenca 2.1.b), Ngarkesën e stafit akademik (Evidenca 4.1.a-e), etj.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" në Albanian University është mirëstrukturuar dhe ofron një përmbajtje të detajuar dhe të organizuar mësimore që përputhet plotësisht me standardet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program i studimit përfshin dy vite akademike të ndara në katër semestra, me një total prej 120 krediteve ECTS, të cilat janë të ndara në mënyrë të barabartë mes dy viteve akademike, ku çdo vit përbëhet nga 60 kredite. Në vitin e parë dhe të dytë, programi përmban një sërë lëndësh bazë dhe të specializuara që janë të ndërtuara për të siguruar një bazë të gjerë dhe të thellë dijesh në fushën e

	<p>teknologjisë së informacionit. Lëndët si "Teoria e Informacionit dhe e Kodimit", "Proceset Stokastike", "Algoritëm dhe Programim i Avancuar", dhe "Menaxhimi i Projekteve të Teknologjisë së Informacionit" janë pjesë e programit dhe ofrojnë një kombinim të teorisë dhe praktikës që është jetik për formimin profesional dhe akademik të studentëve.</p> <p>Veçanërisht, programi përfshin një ngarkesë mësimore të caktuar për çdo lëndë që specifikon orët në auditor për leksione, seminare dhe ushtrime, si dhe orët e dedikuara për studim të pavarur dhe punë jashtë auditorit. Kjo strukturë e qartë siguron që studentët të kenë një orientim të qartë mbi angazhimin e tyre mësimor dhe të përgatiten në mënyrë adekuate për vlerësimet dhe detyrat akademike. Përveç kësaj, programi përfshin lëndë me zgjedhje dhe module të specializuara që lejojnë studentët të thellojnë njohuritë në fusha specifike të interesit, si "Siguria në Rrjetat Kompjuterike" dhe "Programim i Orientuar nga Objekti". Këto lëndë zgjedhore ofrojnë një mundësi për personalizim të mëtijshëm të studimeve dhe për të ndjekur interesa të veçanta shkencore ose profesionale.</p> <p>Praktika profesionale dhe puna e kursit për përmbylljen e programit, si Teza e Diplomës, janë gjithashtu pjesë integrale e kurrikulës, duke siguruar që studentët të aplikojnë dijet dhe aftësitë e tyre në një mjedis profesional real ose në projekte hulumtuese, gjë që i përgatit ato për sfidat e tregut të punës dhe për karriera të mëtijshme akademike ose industriale. (Evidenca 2.1.a-c)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Sipas rregullores për "Rregjistrimet dhe Transferimet" në "Albanian University", informacioni i detajuar në lidhje me ekuivalencën dhe procedurat e pranimit për studentë në vitin e parë të studimeve është i disponueshëm për konsultim. Ky proces është i rregulluar për të siguruar një kalim të qartë dhe të drejtë të krediteve për studentët e rinj (Evidencë 2.5).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore</p>	<p>Çdo lëndë brenda programit të studimit të Masterit i Shkencave "Teknologji Informacioni" ka një syllabus të hartuar në përputhje me planin mësimor. Këto syllabuse dhe informacionet përkatëse janë të aksesueshme dhe përfshijnë detajet rreth përmbajtjes,</p>

<p>(syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>laboratoreve, ushtrimeve dhe të dhënave të tjera relevante në përputhje me elementët e përcaktuara në dokumentin Nr. 2, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (Evidencë 2.1.b).</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Në mars të vitit 2021, Departamenti i Inxhinierive ka shqyrtuar dhe vlerësuar risqet për programin Master Shkencor "Teknologji Informacioni", duke konfirmuar angazhimin e tij për të mbajtur një standard të lartë akademik. Për të siguruar një përditësim dhe relevancë me kohën, programi ka rishikuar dhe përshtatur përqindjen e përmbajtjes së kursit që mbulohet nga literatura e jashtme, duke respektuar limitin e 20% siç është kërkuar nga legjislacioni në fuqi (Evidenca 2.6). Kjo është bërë për të garantuar që studentët marrin njohuri të plota dhe të azhurnuara që janë relevante për nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve të fundit në fushën teknologjike (Evidenca 2.7.a, b, c, d, e)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit etj, janë të detajuara dhe të plota. Departamenti i Inxhinierive ka demonstruar një angazhim të qartë në disponimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Kjo përfshin rregulloren e programit mësimor, syllabuset detajuar për çdo lëndë, si dhe ngarkesën e stafit akademik, duke siguruar që studentët dhe palët e interesuara të kenë qasje në informacion të plotë dhe transparent.</i></p> <p><i>Programi është strukturuar në mënyrë të qartë në katër semestra gjatë dy viteve akademike, me një total prej 120 krediteve ECTS, të ndara në mënyrë të barabartë mes viteve. Planin mësimor dhe organizimi i lëndëve në çdo semestër janë të projektuar për të ofruar një edukim të plotë dhe të thellë në fushën e teknologjisë së informacionit. Lëndët bazë dhe ato të specializuara ofrojnë një kombinim të teorisë dhe praktikës, duke përfshirë elementë si "Teoria e Informacionit dhe e Kodimit", "Proceset Stokastike", dhe "Menaxhimi i Projekteve të Teknologjisë së Informacionit".</i></p> <p><i>Në aspektin e ngarkesës mësimore, programi specifikon qartë orët e kushtuara për leksione, seminare, ushtrime, si dhe për</i></p>

	<p><i>studimin e pavarur dhe aktivitetet jashtë auditorit. Kjo strukturë siguron që studentët të kenë një orientim të qartë dhe të përgatiten adekuat për të përballuar vlerësimet dhe detyrat akademike.</i></p> <p><i>Veç të tjerash, programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, duke u dhënë studentëve të gjitha detajet e nevojshme për të naviguar nëpër procesin akademik me sukses. Ky nivel i organizimit dhe disponueshmërisë së informacionit demonstroi përkushtimin e departamentit për të mbështetur studentët në arritjen e objektivave të tyre edukative dhe profesionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit Albanian University. Institucioni, ka një nga objektivat kryesore ofrimin e programeve të studimit cilësore në fushën e teknologjisë së informacionit, sisteme informatike, atë të përpunimit dhe të transmetimit dixhital të informacionit, matematikës së aplikuar etj. Në strategjinë e tij (Evidenca 1.4.a), AU ka përcaktuar qartë objektivat në planin afatgjatë të zhvillimit të tij, të cilat janë kërkesa bashkëkohore si për stafin akademik ashtu edhe kërkesa për brezin e ri të specialisteve në këto fusha. (Evidenca 2.1.b), (Evidenca H1)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në	Shpërndarja e lëndëve/moduleve në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve (Evidenca 2.1.a).

<p>kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët që përdorin punën laboratorike ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës gjate dy viteve (Evidenca 2.1.a) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 375 orë; - Seminare/Ushtrime 383 orë; - Laboratorë 247 orë; - DK 10 orë; - Praktika 240 orë - Përgatitje për diplomën 36 orë; <p>Raporti i caktuar më sipër, është në përputhje me profilin e programit master dhe të përafëruara me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Njohuritë e marra sipas strukturës të programit (Evidenca 2.1.a) mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, duke i lejuar studentit mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programi i studimit, objekt i këtij vlerësimi të jashtëm, është në nivel Master Shkencor, dhe nga takimet me përfaqësues të departamentit është konstatuar se syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Ky ndryshim reflektohet në fillim të çdo viti në masën e përcaktuar në rregullore për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Biblioteka pasurohet vazhdimisht në funksion të syllabuseve (Evidenca 2.7.a-e), (Evidenca 2.8)</p>



<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" të ofruar nga Albanian University është projektuar për të siguruar një edukim të gjithanshëm në fushën e teknologjisë së informacionit. Me një strukturë të ndarë në dy vite akademike dhe të organizuar në katër semestra, programi përfshin 120 kredite ECTS, të cilat janë të barabartë ndarë për të siguruar një përvojë mësimore të balancuar dhe të plotë. Lëndët e ofruara brenda këtij programi, të tilla si "Teoria e Informacionit dhe e Kodimit", "Proceset Stokastike", dhe "Menaxhimi i Projekteve të Teknologjisë së Informacionit", janë zgjedhur me kujdes për të mbuluar aspektet kryesore dhe të avancuara të fushës, duke përfshirë teorinë kritike dhe aplikimet praktike që janë esenciale për çdo profesionist të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Programi thekson mësimin e përqendruar dhe të orientuar në objektivat finale, ku çdo lëndë specifikon qartë orët në auditor për leksione, seminare dhe ushtrime, si dhe orët e dedikuara për studimin e pavarur dhe aktivitetet jashtë auditorit. Kjo strukturë siguron që studentët të kenë një orientim të qartë mbi përgatitjen e tyre akademike dhe profesional. Përfshirja e lëndëve me zgjedhje dhe praktikës profesionale në planin mësimor u lejon studentëve të personalizojnë edukimin e tyre dhe të zhvillojnë njohuri të thelluara në fusha specifike të interesit, duke rritur aftësitë e tyre analitike dhe zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme profesionale. Përmbajtja e programit është gjithashtu në përditësim të vazhdueshëm për të mbajtur hapin me zhvillimet e fundit teknologjike dhe akademike, duke siguruar që studentët të marrin një arsimim relevant dhe të përparuar që është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe sfidat e industrisë.</p> <p>(Evidenca H.1)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe/ ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës (Evidenca H.1). Kjo tregohet nga një shkallë e kënaqshme e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani shumë prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëri e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" i ofruar nga Albanian University, ka një strukturë të</i></p>

	<p><i>mirëpërcaktuar që përmbush kërkesat e një kurrikule të plotë dhe të integruar, të shpërndarë në mënyrë të qartë ndër vite dhe semestra, duke garantuar një përvojë të gjithanshme dhe të thelluar mësimore për studentët e tij.</i></p> <p><i>Emërtimi i programit dhe përmbajtja e lëndëve të tij janë në përputhje të plotë me fushat akademike dhe orientimet e strategjisë afatgjate të universitetit, të cilat përcaktojnë qartë objektivat në zhvillimin e aftësive, dijeve dhe kompetencave të studentëve në teknologjinë e informacionit, sistemet informatike dhe matematikën e aplikuar. Kjo ndërthurje e kurrikulës me orientimet strategjike të institucionit garanton një arsimim relevant dhe të përditësuar që përgjigjet jo vetëm nevojave akademike por edhe atyre profesionale të studentëve. Lëndët dhe modulat e programit janë të ndërtuara me një balanc të saktë mes teorisë dhe praktikës, ku leksionet, seminarët, ushtrimet dhe laboratorët janë të integruar për të ofruar njohuri thelbësore dhe aplikime praktike. Kjo shpërndarje jo vetëm që siguron njohuri të thella akademike, por gjithashtu zhvillon aftësi praktike që janë thelbësore për suksesin në tregun e punës. Veçanërisht, përfshirja e praktikave profesionale dhe përgatitjes për diplomën e mëtejshme siguron që studentët të kenë mundësi të aplikojnë dijet në një kontekst real punësimi, duke i bërë ata kandidatë të preferuar për punëdhënësit. Më tej, programi vazhdimisht rishikohet dhe përditësohet për të siguruar që të mbetet relevant dhe përputhet me zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjisë së informacionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për	Nga biseda e GVJ me përfaqësues të departamentit dhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua studimi periodik i tregut nga Departamenti i Inxhinierive me synim

<p>përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës (Evidenca 2.9.a), (Evidenca 2.9.b). Nga takimet me përfaqësues të departamentit dhe studentë, rezulton se institucioni për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet me përfaqësues të departamentit dhe studentë, rezulton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Mendimet e studentëve shprehen nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në Senat, kurse mendimet e studentëve të diplomuar nëpërmjet të zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga takimet me përfaqësues të departamentit dhe studentë, rezulton se Njësia përgjegjëse mban kontakte të vazhdueshme dhe punon duke u bazuar edhe tek propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, dhe ekspertë nga institucione publike e private. Nga (Evidenca 2.10) rezulton se në Grupin e Ekspertëve janë përfshirë edhe ekspertë të jashtëm.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në përgjithësi dhe Departamenti i Inxhinierive në veçanti, analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpunëtorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimeve Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është hartuar me qëllimin për të siguruar që studentët të përfitojnë njohuri dhe të zhvillojnë aftësi të cilat janë thelbësore për hulumtimin shkencor dhe avancimin teknologjik, në linjë me synimet dhe objektivat e përgjithshëm të institucionit. (Evidenca H1)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Aktivitetet e kërkimit shkencor që zhvillohen brenda Departamentit të Inxhinierive janë në përputhje të plotë me standardet dhe etikën e lirisë akademike, të cilat janë të mbështetura dhe të respektuara nga administrata dhe personeli akademik. (Evidenca 1.2)
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë angazhohet në zbatimin e praktikave inovative për të stimuluar zhvillimin dhe realizimin e ideve të studentëve, duke i përfshirë ata në projekte gjatë kursit të tyre dhe në aktivitete të mëtejshme si pjesëmarrjen në konferenca dhe publikime në revistën e universitetit "Optime". Këto iniciativa synojnë të nxisin përfshirjen e studentëve në diskutime akademike dhe të rrisin eksponimin e tyre në skenën akademike dhe profesionale. (Evidenca 3.8.a, b, c-e), (Evidenca 3.9). Institucioni garanton që ka në dispozicion laboratorët dhe bazën materiale që nevojiten për të mbështetur këto ide dhe projekte, duke siguruar kushtet e duhura për realizimin me sukses të iniciativave të studentëve dhe të promovojë bashkëpunimin

	dhe shkëmbimin e njohurive në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga takimet me përfaqësues të departamentit dhe studentë, GVJ konstaton se institucioni ofron ndihmesë financiare për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore. Njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.
Konkluzione	<p><i>Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" në Albanian University është dizajnuar për të ofruar një arsimim që synon të zhvillojë njohuri të avancuara dhe aftësi esenciale për hulumtimin shkencor dhe avancimin teknologjik. Ky program është në përputhje të plotë me synimet dhe objektivat e përgjithshëm të institucionit, të cilat janë të fokusuara në nxitjen e inovacionit dhe zhvillimit profesional të studentëve.</i></p> <p><i>Aktivitetet e kërkimit shkencor të zhvilluara brenda Departamentit të Inxhinierive janë një tregues i qartë i angazhimit të universitetit për të ruajtur standarde të larta akademike dhe për të respektuar etikën e lirisë akademike. Këto aktivitete janë të mbështetura në mënyrë të fortë nga administrata dhe personeli akademik, të cilët kontribuojnë në një mjedis stimulues dhe inkurajues për hulumtim.</i></p> <p><i>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aplikimin e praktikave inovative dhe në përfshirjen aktive të studentëve në projekte dhe aktivitete hulumtuese, të cilat përfshijnë pjesëmarrjen në konferenca dhe publikime në revistën e universitetit "Optime". Këto iniciativa jo vetëm që ofrojnë përvoja praktike dhe rritin aftësitë e studentëve, por gjithashtu rrisin eksponimin e tyre në komunitetin akademik dhe profesional, duke i përgatitur ata për sfidat e karrierës së tyre të ardhshme.</i></p> <p><i>Institucioni siguron gjithashtu infrastrukturën e nevojshme, përfshirë laboratorët dhe bazën materiale, për të mbështetur realizimin e projekteve shkencore dhe akademike. Kjo mundëson zhvillimin e ideve të studentëve në një mjedis që promovon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e dijeve në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ vëren se universiteti ofron mbështetje</i></p>

	<i>financiare për aktivitetet studimore dhe shkencore, duke garantuar që njësia bazë të ketë burime të mjaftueshme për të administruar dhe zbatuar të ardhurat nga aktivitete të ndryshme në mënyrë efektive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Departamenti i Inxhinierisë mbështet dhe promovon aktivitetet e hulumtimit dhe të mësimi të përbashkët, duke u bazuar në grupe pune dhe projekte të drejtuara nga stafi akademik, që kontribuojnë në përparimin e programit të studimeve si dhe në përmbushjen e objektivave të kërkimit shkencor. Departamenti bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë si PKZH dhe programe europiane si Erasmus+ për të nxitur dhe zgjeruar bashkëpunimet dhe shkëmbimet akademike.</p> <p>(Evidenca 1.1.a-e)</p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Përfaqësues të Departamentit dhe studentë konfirmuan angazhimin për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe për tu perfshire në procesin e realizimit të këtyre objektivave.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin	Departamenti ka qenë organizator i Konferencës Ndërkombëtare në temën e standardizimit, prototipave dhe cilësisë, duke u përqendruar në bashkëpunimin mes vendeve të Ballkanit, dhe ka qenë partner në organizimin e konferencave të ngjashme për të nxitur bashkëpunimin akademik dhe shkëmbimin e njohurive në

dhe studentët për arritjen e objektivave.	nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Këto iniciativa janë krijuar për të mbështetur studentët dhe stafin akademik në zhvillimin e tyre profesional dhe akademik në fusha të ndryshme të inxhinierisë. (Evidenca 1.1.a-e)
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Nga biseda me studentë dhe përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit, GVJ konstaton se ky kriter plotësohet. Tregues për këtë shërben numri i konsiderueshëm i studentëve të punësuar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga takimi me përfaqësues të departamentit, konstatohet angazhimi i njësisë përgjegjëse për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N / A
Konkluzione	<i>Departamenti i Inxhinierive ka treguar angazhim dhe përkushtim ndaj zhvillimit shkencor dhe akademik, si dhe promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe hulumtimit të përbashkët. Ky departament jo vetëm që mbështet aktivitetet e kërkimit dhe të mësimin nëpërmjet grupeve të punës dhe projekteve që drejtohen nga stafi akademik, por gjithashtu bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë si Programi i Kërkimeve Shkencore dhe Teknologjike të Zvicrës (PKZH) dhe programe europiane si</i>

<p><i>Erasmus+, për të zgjeruar dhe thelluar shkëmbimet dhe bashkëpunimet akademike.</i></p> <p><i>Nëpërmjet këtyre partneriteteve, Departamenti i Inxhinierisë ka organizuar dhe marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare që synojnë të nxisin bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, duke u fokusuar në tema si standardizimi, prototipat dhe cilësia. Këto iniciativa kanë krijuar platforma të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe për zhvillimin e mëtejshëm të stafit dhe studentëve në fusha të ndryshme të inxhinierisë.</i></p> <p><i>Përveç kësaj, angazhimi i departamentit për të përmbushur kërkesat për analiza dhe studime të ndryshme me karakter kërkimor shkencor dhe për të përfshirë studentët në këto procese konfirmon më tej përkushtimin e tij për zhvillimin akademik dhe profesional të të diplomuarve të tij. Një tregues i qartë i suksesit të këtij angazhimi është numri i konsiderueshëm i studentëve të punësuar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, siç është vërejtur nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) dhe përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</i></p> <p><i>Departamenti vazhdon të jetë i angazhuar në shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, dhe rrjetet profesioniste për të siguruar se programet e studimit dhe kompetencat e ofruara janë në përputhje me kërkesat ligjore të fushës dhe nevojat e licencimit të profesionit përkatës.</i></p>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit (Evidenca 1.1 a-e). Syllabuset e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu, plani mësimor është në përputhje me Rregulloren e Miratuar të programit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik i programit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është i përfshirë në trajnime që fokusohen në strategjitë didaktike të mësimdhënies të organizuara nga Albanian University (Evidenca 3.1 a-c). Ata, gjatë interaksionit me studentët, inkurajohen të aplikojnë metoda të reja dhe kreative në procesin e mësimdhënies. Akademikët vënë në qendër të vëmendjes nevojat e studentëve dhe punojnë ngushtë me ta për të siguruar një përvojë mësimore të cilësisë së lartë. Metodatat inovative të mësimdhënies që zbatohen përfshijnë simulimet, materialet video, dhe përdorimin e softuerëve specifikë për analiza të ndryshme dhe të pavarura.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni demonstroi se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe ka mbështetur personelin e tij akademik me trajnimin dhe aplikimin e metodave të ndryshme pedagogjike të mësimdhënies (Evidenca 3.1 a-c). Për këtë qëllim mbështet organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca të organizuara nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera. Gjithashtu stafi akademik këshillohet të marrë pjesë në aktivitete të tjera shkencore dhe mbështetet financiarisht nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në</p>	<p>Shumica e programit studimor ofrohet nga stafi akademik i institucionit, i cili përfaqëson një nivel të lartë të ekspertizës në</p>

<p>shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>fushat që ata mësojnë dhe disponon përvojë të konsiderueshme në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe përditëson periodikisht mënyrat dhe metodat e mësimdhënies me anë të implementimit të Pyetësorëve mbi Vlerësimin e Lektorit të Lëndës i cili është një nga mjetet kryesore të përdorura për kontrollin e cilësisë të mësimdhënies. Ky pyetësor mbahet në bazë semestrale. Raporti i vihet në dispozicion çdo pedagogu dhe strukturave drejtuese (Evidenca 6.9 a-g). Nga takimi me studentet u konstatua se ky mekanizëm kishte funksionuar në disa raste në përmirësimin e mësimdhënies në disa lëndë formuese bazë ku mangësitë e studentëve në njohuritë paraprake nga shkolla e mesme, ishin plotësuar me ndihmën e stafit akademik të institucionit.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë</p>	<p>Stafi akademik, në veprimtarinë e tyre ditore gjatë procesit arsimor, është i angazhuar në tranzicionin nga mësimdhënia tradicionale drejt një qasjeje më interaktive, duke theksuar rëndësinë e praktikave, projekteve, angazhimit në kërkime shkencore të mësimdhënësve, punës grupore, etj. Këto ndryshime kanë për qëllim të stimulojnë dhe të kultivojnë aftësi si:</p> <p>Kreativiteti;</p> <p>Punë në grup dhe komunikim efikas;</p> <p>Ndërgjegjësim dhe marrje përgjegjësisë;</p> <p>Individualiteti;</p> <p>Zhvillimi i imagjinatës krijuese;</p> <p>Iniciativa për të vepruar;</p>

vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Artikulimi i qartë në shkrim dhe në fjalë. Në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka angazhuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. (Evidenca 1.3)			
Konkluzione	<i>AU ka të ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit. Vlerësimi i njohurive bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm duke kombinuar: <ul style="list-style-type: none"> - Provimi përfundimtar (60%) - Provimi i ndërmjetëm (20%) - Frekuentimi/DK (20%) Kontrolli behet me goje, shkrim apo projekte kursi. (Evidenca H1)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit (Evidenca 1.6) deri në njësinë bazë si dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit të studimit, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjës për këtë program studimi ka tre tipologji të vlerësimit të dijeve të studentëve (Evidenca H1):</p> <ul style="list-style-type: none"> - me provim përfundimtar (60%); - me provim të ndërmjetëm (20%); - pjesëmarrje dhe detyra (20%);
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përputhje me rregulloret e programit të studimit dhe metodat e vlerësimit të përcaktuara në Albanian University, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) ka konstatuar që kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve janë të qarta dhe të strukturuar mirë. Këto përcaktime synojnë të sigurojnë një vlerësim të drejtë dhe të efektiv të arritjeve të studentëve nëpërmjet një procesi të kontrollit të vazhdueshëm dhe të gjithëpërfshirës, duke kombinuar provimin përfundimtar, provimin e ndërmjetëm, dhe pjesëmarrjen si dhe detyrat e kursit. Struktura e vlerësimit përbëhet nga:</i></p> <p><i>Provimi përfundimtar që përbën 60% të notës përfundimtare;</i></p> <p><i>Provimi i ndërmjetëm që kontribuon me 20%;</i></p> <p><i>Frekuentimi dhe detyrat e kursit që gjithashtu llogariten për 20% të vlerësimit total;</i></p> <p><i>Kjo metodologji e vlerësimit siguron një pasqyrë të qartë të performancës së studentit gjatë gjithë periudhës së kursit, duke nxitur përkushtimin e vazhdueshëm dhe përfshirjen aktive të studentëve në proceset mësimore. Vlerësimi mund të bëhet përmes provimeve me gojë, në formë të shkruar, apo përmes projekteve të kursit, të cilat ofrojnë një mundësi për të demonstruar aftësitë analitike dhe zbatimin praktik të dijeve të fituara. Në fillim të çdo moduli ose lënde, studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit për metodologjinë e vlerësimit të përdorur, si dhe për pritjet dhe kriteret specifike që duhet të përmbushen. Kjo transparencë në komunikimin e metodave të vlerësimit siguron që studentët të jenë të përgatitur dhe të orientuar drejt objektivave të tyre mësimore.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i dijeve të studentëve, konform rregulloreve institucionale, të njësisë kryesore dhe asaj bazë, bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës (Evidenca H1)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk disponon sisteme të tilla. Vlerësimi behet në bazë të kontrollit të vazhdueshëm, dhe tezat sekretohen para korrigjimit nga pedagogu i lëndës.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi duke mbledhur pikët e provimit përfundimtar (60%) (Evidenca H1)
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e Albanian University. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/ testeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/ prezantimeve të detyrave të kursit/ projekteve, duke iu dhënë

	këshilla/ orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti dhe stafi akademik ndjekin rregulloren për provimet dhe etikën, e cila përcakton procedurat për mbikëqyrjen e provimeve dhe masat disiplinore në rast të plagjiaturës. Në lidhje me detyrat e kursit, personeli akademik dhe udhëheqësit e departamentit dhe të Fakultetit nxisin dhe aprovinin tema të cilat janë kryesisht praktike ose teorikisht aplikative, duke kërkuar përdorimin e të dhënave autentike (Evidenca H1). Çdo anëtar i stafit, qoftë akademik apo jo akademik, në bazë të përgjegjësive të tyre të caktuara, është i obliguar të ruajë një standard të lartë të integritetit në çdo situatë, bazuar në kontratën e pedagogut dhe Rregulloren e Etikës (Evidenca 6.11)
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi informatic Pitagora, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në sekretari (Evidenca H1). Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigohet nga komisioni dhe brenda 7 ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në department.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore (Evidenca 3.6), (Evidenca H1).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga Dekani i Fakultetit i cili ngre një komision ad-hoc ku përfshihet edhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. (Evidenca H1). Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e ketij programi studimi, u vu re se studentët në përgjithësi merrnin

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	pergjigje apo qartësoheshin rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në duke disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve.			
Konkluzione	<p><i>Vlerësimi i njohurive të studentëve në programin Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" të Albanian University është strukturuar në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me rregulloret institucionale të universitetit. Procesi i vlerësimit përbëhet nga komponentë të ndryshëm që synojnë të masin njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e studentëve në mënyrë të gjithanshme. Këto përfshijnë provimin përfundimtar, i cili llogaritet për 60% të notës, provimin e ndërmjetëm që përbën 20%, dhe frekuentimin dhe detyrat e kursit që gjithashtu vlerësohen për 20% të notës finale.</i></p> <p><i>Vlerësimi realizohet nëpërmjet metodash të ndryshme si provime me shkrim, me gojë dhe projekte kursi, duke siguruar që të gjithë studentët të jenë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Ky proces i vlerësimit është në përputhje të plotë me parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe siguron një vlerësim të drejtë dhe transparent të performancës së studentëve.</i></p> <p><i>Në fillim të çdo moduli ose lënde, studentët janë të informuar nga titullari i lëndës për metodologjinë e vlerësimit dhe për pritjet specifike që lidhen me syllabusin e lëndës. Kjo i ndihmon ata të përgatiten në mënyrë adekuate për provimet dhe të menaxhojnë kohën e tyre mësimore për të arritur rezultate të mira.</i></p> <p><i>Universiteti gjithashtu garanton integritetin në procesin e vlerësimit përmes mbikëqyrjes së rregullt të provimeve dhe zbatimit të masave disiplinore në rast të plagjiaturës. Pedagogët janë të angazhuar në ofrimin e feedback-ut konstruktiv gjatë orëve të seminareve dhe ndihmojnë studentët në përvetësimin e dijeve dhe përgatitjen për detyrat e kursit, duke u siguruar atyre këshilla dhe orientime për përmirësimin e performancës së tyre akademike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Pas analizimit të dokumentacionit të përcaktuar, GVJ vëren se programi akademik përfshin kurse teorike në fushën e teknologjisë së informacionit gjate dy viteve, duke kulminuar me dorëzimin e tezës së diplomës (Evidenca H1). Përveç ofertës akademike, departamenti gjithashtu siguron shërbime shtesë si konsultime dhe leksione të hapura, ndërsa stafi akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në aktivitete jashtë mësimore, duke i përgatitur ata për avancimin në studimet master. Studentët marrin pjesë aktive në shkëmbime që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të tyre në IT, programim, dhe njohuritë e softuerëve të ndryshëm. Përfshirja në projekte kërkimore të stafit akademik është një tjetër aspekt, ku studentët inkurajohen të punojnë në grup. Seminaret organizojnë diskutime mbi tema të caktuara, duke ndarë studentët në grupe me role specifike, ku çdo grup përfaqëson një shtresë interesi, duke promovuar një mjedis interaktiv dhe kolaborativ të mësimi.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni", studentët zhvillojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre në fushën e inxhinierisë informatike, që janë të rëndësishme për karrierën e tyre profesionale dhe përputhen me profilin e përcaktuar të programit. Detyrat dhe projektet e kursit janë të përqendruara në përvetësimin e njohurive komunikuese dhe të ndërveprimit në grup, që janë thelbësore për zhvillimin profesional të studentëve. Përveç kësaj, përmes raporteve të detajuara, studentët tregojnë përvojën e tyre dhe përgatitjen që kanë marrë gjatë studimeve. Gjatë semestrave, studentët angazhohen në punë të ndryshme si detyrat e kursit dhe projektet laboratorike, që synojnë të zhvillojnë dhe të testojnë aftësitë e tyre analitike dhe praktike. Këto detyra janë një përgatitje kyçe për tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive të studentëve, duke ndihmuar në arritjen e qëllimeve akademike dhe profesionale. (Evidenca 2.1.a-b)</p>

<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raporte mbi realizimin e objektivave të mësimdhënies, të cilat janë të bazuar në performancën dhe zhvillimin e studentëve. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar dhe për të ilustruar temat që janë trajtuar dhe argumentet kryesore, duke përfshirë edhe punën e studentëve në projektet që kanë lidhje me industri. (Evidenca 3.7.a), (Evidenca 2.1.b)</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i Masterit i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është i strukturuar në një mënyrë që të përfshijë një balancë midis teorisë dhe praktikës, me qëllimin e zhvillimit të një mësimdhënie që përfshin të gjithë spektrin e aftësive dhe kompetencave të nevojshme për tregun e punës. (Evidenca 2.1.a)</p> <p>Disa nga detyrat e kursit janë zhvilluar në grup, për të nxitur bashkëpunimin dhe për të rritur efektivitetin e mësimdhënies përmes diskutimit të temave. Kjo strategji ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit në mes të studentëve. Stafi akademik në Departamentin e Inxhinierisë mbështet zhvillimin e studentëve jo vetëm nëpërmjet detyrave të kursit, por edhe përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe publikimet e tyre në revistën e universitetit "Optime", duke promovuar kështu arritjet e tyre dhe të ndihmojnë në rrugëtimin e tyre akademik dhe profesional. (Evidenca 3.8.a-d), (Evidenca 3.9.a-b). Institucioni ka rezultate të kënaqshme në programe ndërkombëtare si Erasmus etj. (Evidenca 1.1.a-e)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme fton specialistë nga industria për të ndare eksperiencën e tyre me studentët. (Evidenca 1.1.a-e)</p>

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga materialet në dispozicion dhe takimet me studentët, ata shprehën kënaqësi për nivelin e përfshirjes të tyre dhe mbështetjen nga institucioni në zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore. (Evidenca 1.1.a-e)
Konkluzione	<p><i>Programi Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" në Albanian University është hartuar për të ofruar një edukim të plotë dhe gjithëpërfshirës në fushën e teknologjisë së informacionit, duke u përqendruar në zhvillimin e njohurive të thella teorike dhe praktike që janë të domosdoshme për karrierën akademike dhe profesionale të studentëve. Ky program synon të përmbushë objektivat e përgjithshme të institucionit për avancimin e hulumtimit shkencor dhe zhvillimin teknologjik.</i></p> <p><i>Programi përfshin kurse teorike dhe praktike që zhvillohen gjatë dy viteve akademike dhe kulmojnë me dorëzimin e tezës së diplomës. Përveç ofertës akademike, departamenti ofron gjithashtu shërbime shtesë si konsultime dhe leksione të hapura, që janë të rëndësishme për përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe studimet më të avancuara. Aktivitetet jashtëmësimore si pjesëmarrja në projekte kërkimore, seminarët dhe diskutimet në grupe të ndryshme, nxisin zhvillimin e aftësive të studentëve në fushat e IT, programimit dhe softuerëve të ndryshëm.</i></p> <p><i>Departamenti i Inxhinierisë bashkëpunon ngushtë me partnerë ndërkombëtarë si PKZH dhe programe europiane si Erasmus+, për të promovuar dhe zgjeruar bashkëpunimet dhe shkëmbimet akademike. Këto iniciativa ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të pasur akademik dhe kolaborativ, ku studentët mund të zhvillojnë aftësitë e tyre komunikuese dhe të punojnë në grup për të zgjidhur sfida komplekse. Detyrat dhe projektet e kursit janë të përqendruara në përvetësimin e njohurive dhe ndërveprimin në grup, duke i bërë studentët të aftë për të ndarë ide dhe të marrin pjesë në diskutime që rrisin efektivitetin e tyre si profesionistë të ardhshëm në fushën e inxhinierisë informatike.</i></p> <p><i>Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raporte mbi realizimin e objektivave të mësimdhënies, duke bazuar vlerësimet në performancën e studentëve dhe në përgatitjen e</i></p>



	<i>tyre gjatë periudhës së studimeve. Këto raporte janë thelbësore për të vlerësuar suksesin e metodave të mësimdhënies dhe për të siguruar që çdo student të marrë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të arritur qëllimet e tyre profesionale dhe akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në përfundim të ciklit akademik, Departamenti zbaton një proces të vlerësimit të të diplomuarve, ku theksohet arritja e qëllimeve të programit dhe aftësitë e fituara nga studentët. Ky proces përfshin dorëzimin e një teze, e cila duhet të reflektojë një temë të miratuar nga departamenti dhe të jetë e bazuar në hulumtim dhe projekte të ndërmarra nga studentët gjatë studimeve të tyre. Struktura e tezës bazohet në udhëzime akademike dhe synon të ilustrojë punën kërkimore dhe aftësitë e analizës të studentit. (Evidenca H1)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Për t'u diplomuar, studentët duhet të përmbushin kërkesat e programit duke aplikuar njohuritë akademike dhe të përgatiten për mbrojtjen e tezës së tyre të diplomës, e cila duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e departamentit dhe të paraqesë një kontribut në fushën e tyre studimore. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion material dhe udhëzime për të ndjekur gjatë gjithë procesit të përgatitjes, deri në dorëzimin dhe mbrojtjen e tezës. (Evidenca 3.5.a-b)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike. Procesi i diplomimit në programin e masterit përfshin edhe mbrojtjen e një teze, një projekt kërkimor që reflekton punën e studentëve gjatë dy viteve të studimeve. Kjo përfshin një periudhë të detajuar të përgatitjes dhe shkrimit të tezës në

gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	përputhje me metodologjinë dhe materialet e përcaktuara nga departamenti për të siguruar një punim cilësor dhe të plotë.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	Udhëheqësi i temës së diplomës mbikëqyr punën e studentit përgjatë gjithë procesit të shkrimit të tezës, duke siguruar që metodologjia dhe burimet të përdoren siç duhet. (Evidenca H1)
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	Departamenti i Inxhinierisë ka në dispozicion laboratorët dhe stafin ndihmës për të mbështetur studentët gjatë përgatitjes së punimeve të tyre të diplomës. Këto resurse janë esenciale për të siguruar një përgatitje cilësore dhe për të ndihmuar studentët të realizojnë projekte të suksesshme.
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, procesi i vlerësimit të studentit në programin Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" finalizon procesin e përgatitjes akademike dhe profesionale të studentit në fushën e teknologjisë të Informacionit.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar nëpërmjet një provimi të përgjithshëm ose mbrojtjes së punimit të diplomës është i strukturuar për të pasqyruar njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë programit të studimit. Ky vlerësim përfundimtar, i cili zakonisht përbëhet nga një kombinim i provimeve me shkrim, prezantimeve orale, dhe mbrojtjes së projekteve të diplomës, ofron një mundësi për</p>



	<p>studentët për të demonstruar aftësinë e tyre për të sintetizuar dhe të transmetojnë njohuritë e tyre në mënyrë efektive. Vlerësimi me notë në fund të këtij procesi është i bazuar në performancën e përgjithshme të studentit gjatë provimeve dhe mbrojtjes, si dhe në përputhje me kriteret e paracaktuara në syllabusin e lëndës dhe rregulloren e universitetit. (Evidenca E.3)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS. (Evidenca E.2-3) Në përfundim të studimeve, me kërkesë, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. (Evidenca 3.11)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ruan dhe përditëson në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përfundim të ciklit akademik të programit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" në Albanian University, studentët kalojnë në një proces të detajuar dhe të rregullt vlerësimi. Ky proces vlerësimi përfshin dorëzimin e një teze të diplomës, e cila duhet të reflektojë një temë të miratuar dhe të jetë bazuar në hulumtimet dhe projektet e zhvilluara gjatë studimeve. Teza duhet të ilustronë në mënyrë të qartë punën kërkimore dhe aftësitë analitike të studentit, duke u mbështetur në udhëzimet akademike dhe të përcaktuara nga departamenti.</i></p> <p><i>Procesi i mbrojtjes së tezës është përcaktuar në rregulloren e universitetit dhe kërkon që studentët të përmbushin kërkesat e programit duke aplikuar njohuritë akademike që kanë fituar. Staf i akademik dhe strukturat përgjegjëse ofrojnë ndihmë të vazhdueshme gjatë këtij procesi, duke siguruar materiale, udhëzime dhe mbështetje në përgatitjen e tezës. Kjo përfshin një</i></p>

	<p><i>periudhë të detajuar të përgatitjes dhe shkrimit të tezës në përputhje me metodologjinë e miratuar dhe materialet e disponueshme, duke garantuar kështu një punim cilësor dhe të plotë.</i></p> <p><i>Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet duke u bazuar në performancën e tyre gjatë provimeve me shkrim, prezantimeve orale dhe mbrojtjes së projekteve të diplomës. Ky vlerësim përfundimtar është i strukturuar për të pasqyruar arritjet e studentit në përmbushjen e qëllimeve të programit dhe në demonstrimin e aftësive të tyre për të sintetizuar dhe transmetuar njohuritë në mënyrë efektive.</i></p> <p><i>Procesi i vlerësimit dhe diplomimit përfundon me lëshimin e diplomës dhe suplementit të diplomës, të cilat janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe japin një përmbledhje të plotë të kursit të studimit dhe arritjeve të studentit. Në kërkesë të studentit, gjithashtu vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, që ofron një dokumentacion të detajuar dhe transparent të rrugëtimit akademik të studentit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës	Departamenti i Inxhinierive në Albanian University ka një angazhim të qartë dhe të strukturuar ndaj ofrimit të mësimdhënies cilësore dhe zhvillimit profesional të studentëve, sidomos në fushat që kërkojnë njohuri të thella teknike si teknologjia e informacionit. Një aspekt kyç i këtij angazhimi është siguri i mjedisve të përshtatshme për realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale, të cilat janë thelbësore për përvetësimin praktik të dijeve teorike.

<p>laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Laboratorët brenda departamentit janë të pajisur me teknologji të avancuar dhe mjete të nevojshme që mundësojnë zhvillimin e eksperimenteve dhe projekteve të ndryshme që mbështesin mësimin praktik dhe eksplorimin shkencor. Këto laboratorë ofrojnë një platformë ku studentët mund të aplikojnë konceptet e mësuara në klasë në një mjedis të kontrolluar, duke u lejuar atyre të eksperimentojnë dhe të mësojnë nga përvoja e drejtpërdrejtë. Praktika laboratorike jo vetëm që ndihmon në thellimin e njohurive teknike, por gjithashtu përmirëson aftësitë e zgjidhjes së problemeve dhe të punës në grup. Përveç laboratorëve, departamenti gjithashtu siguron mundësi për praktikë profesionale, ku studentët angazhohen në projekte të reja që i përgatisin ata për sfidat e tregut të punës. Këto praktika janë dizajnuar për të integruar dijet teorike me aplikimin praktik në situata reale pune. Ato shpesh janë të lidhura me kompani të jashtme ose projekte të brendshme që adresojnë nevoja specifike të industrisë, duke u ofruar studentëve rastin të zhvillojnë aftësi të rëndësishme profesionale dhe të ndërtojnë lidhje të dobishme në fushën e tyre të studimit. Departamenti mbështet zhvillimin e aftësive profesionale dhe akademike të studentëve përmes mentorimit të vazhdueshëm dhe mbikëqyrjes nga stafi akademik. Pedagogët dhe profesionistët e fushës ndihmojnë studentët gjatë gjithë procesit të mësimdhënies, nga planifikimi i projekteve deri në zbatimin e tyre, dhe ofrojnë udhëzime të vazhdueshme për të siguruar që studentët të përmbushin qëllimet e tyre mësimore dhe profesionale. (Evidenca 1.5), (Evidenca 4.5), (Evidenca 4.6)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Nga komunikimi me stafin e departamentit, studentët dhe vizitat në ambientet e institucionit, GVJ konstatoi se ky kriter plotësohet. (Evidenca 1.5), (Evidenca 4.5), (Evidenca 4.6)</p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë</p>	<p>Institucioni ka rreth 30 bashkëpunime jashtë institucionit për të mundësuar praktikrat profesionale dhe stazhet e zhvilluara. Në këto aktivitete studentët asistohen nga stafi pedagogjik i caktuar</p>

<p>studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>dhe përfaqësues të institucionit ku po kryhet aktiviteti. Nga komunikimi me sekretarinë mësimore institucioni ka procedura për ekuivalentimin e aktiviteteve në kredite dhe dokumentimin në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Inxhinierive në Albanian University demonstroi një angazhim të qartë dhe të strukturuar për të ofruar mësimdhënie cilësore dhe për të nxitur zhvillimin profesional të studentëve, veçanërisht në fushat teknike si teknologjia e informacionit. Një element kyç i këtij angazhimi është investimi në mjedise të përshtatshme laboratorike dhe profesionale që mundësojnë aplikimin praktik të njohurive teorike. Laboratorët e departamentit ofrojnë platforma ku studentët mund të ushtrojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre përmes eksperimenteve dhe projekteve të ndryshme, duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës dhe duke u mundësuar të zhvillojnë aftësi të rëndësishme në zgjidhjen e problemeve dhe punën në grup.</i></p> <p><i>Përtej mësimdhënies në laboratorë, departamenti siguron mundësi për praktika profesionale nëpërmjet bashkëpunimeve me kompani dhe organizata të jashtme. Këto praktika jo vetëm që integrojnë dijet teorike me përvojat praktike në situata reale pune, por gjithashtu ndihmojnë në ndërtimin e rrjeteve profesionale dhe zhvillimin e aftësive që janë thelbësore për karrierën e studentëve.</i></p> <p><i>Nëpërmjet mentorimit të vazhdueshëm dhe mbikëqyrjes nga stafi akademik, studentët janë mbështetur në çdo hap të procesit mësimor, që nga planifikimi i projekteve deri në zbatimin e tyre. Ky suport i pandërprerë garanton që studentët të përmbushin qëllimet e tyre mësimore dhe profesionale, dhe të zhvillojnë aftësi kritike për karrierat e tyre të ardhshme.</i></p> <p><i>Vizitat në terren dhe komunikimet me stafin dhe studentët e departamentit kanë konfirmuar efikasitetin dhe ndikimin pozitiv të këtyre programeve dhe mjediseve të mësimdhënies. Departamenti ka rreth 30 bashkëpunime me entitete të jashtme për të siguruar që studentët të përfitojnë nga praktikat dhe stazhet profesionale, të cilat janë të mbështetura dhe</i></p>



	<i>dokumentuara në mënyrë adekuate për të reflektuar kontributin dhe vlerësimin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1							
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni” kryesisht përmbush kërkesat ligjore për nivelin e kualifikimit akademik dhe profili i tyre është në përputhje me natyrën e programit të studimit dhe moduleve të tij. (Evidencë 4.1, 4.2, aneks tabelat përmbledhëse 1, 2, 6, 7, 12.) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në këtë program studimi janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë:						
		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	Tituj/ grada	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	-	2	2	2	2	2	

	Dr./PhD.	4	1	3	-	3	1															
	Msc.	1	-	-	-	-	-															
	Totali	5	3	5	2	5	3															
	<p>Megjithatë gjatë vitit akademik 2020-2021 në këtë program studimi është aktivizuar edhe personel akademik me Msc (1) duke mos plotësuar në këtë rast kërkesat për kualifikimin e personelit akademik të paktën një nivel më lartë se programi ku aktivizohen në mësimdhënie.</p>																					
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon 69%-75% të ngarkesës mësimore të programit të studimit (evidence 4.1) por kjo arrihet duke krijuar një mbingarkesë në normën mësimore vjetore të një pjese të personelit akademik efektiv duke tejkaluar numrin e moduleve në semestër (mbi 3) apo ngarkesën vjetore në auditor (500+ orë) (tabela përmbledhëse 4)</p> <p><i>Kjo problematikë është evidentuar edhe në akreditimin e mëparshëm dhe akoma nuk është adresuar nga institucioni për shkak të vështirësive në rekrutimin e personelit akademik efektiv te kategorisë lektor ose profesor.</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>tabelat 12.4-12.5 Tabela Aneks RVB</i>) u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për dy vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>1015</td> <td>771</td> <td>244</td> <td>75% / 25%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>1015</td> <td>705</td> <td>310</td> <td>69% / 31%</td> </tr> </tbody> </table>							Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	1015	771	244	75% / 25%	2022-2023	1015	705	310	69% / 31%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																		
2021-2022	1015	771	244	75% / 25%																		
2022-2023	1015	705	310	69% / 31%																		
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e</p>	<p>Institucioni gjatë periudhës 2018-2023 ka treguar një qëndrueshmëri në numrin e personelit akademik efektiv të punësuar pranë njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit (tabela përmbledhëse 1).</p> <p><i>Megjithatë bazuar në ngarkesën aktuale të personelit akademik kërkohet që të rritet numri i personelit akademik efektiv i kategorive lektor dhe profesor.</i></p>																					

<p>punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni zotëron dosjet e personelit akademik duke përfshirë edhe kontratën e punësimit sipas formatit të dorëzuar në dokumentacionin e akreditimit (evidencë 4.3). Ky dokumentacion ruhet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka procedura të qarta për përcaktimin e kriterëve për rekrutimin e personelit akademik si dhe për përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm në përputhje me kriteret dhe natyrën e programit të studimit dhe moduleve të tij. Nga ana e IAL në evidence janë mundësuar të gjitha procedurat e ndjekura për rekrutimin e personelit akademik në periudhën 2020-2023 (evidencë R1).</p> <p>Këto procedura janë në përputhje me mënyrën se si janë të pasqyruara në rregulloret e brendshme të institucionit (evidencë 1.6).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për mirëmbajtjen e laboratorëve mësimor për njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit aktualisht është i angazhuar 1 (një) personel ndihmës akademik (tabela përmbledhëse 2) i cili zotëron diplomë të ciklit të dytë master i shkencave.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe</p>	<p>Nga verifikimet gjatë vizitës në IAL, të dhënat e personelit akademik në lidhje me angazhimin e tyre mësimor në programin e studimit dhe në lidhje me aktivitetin e tyre kërkimor shkencor ruhen në arkivën e njësisë bazë përgjegjëse. Ky informacion përditësohet nga personeli akademik të paktën një herë në vit.</p> <p>Dokumentacioni në lidhje me kualifikimet e personelit akademik dhe marrëdhëniet financiare midis personelit akademik dhe institucionit mirëmbahet dhe përditësohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p>



vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për përcaktimin e personelit akademik përgjegjës për mbikëqyrjen e praktikave mësimore si dhe mbrojtjen dhe udhëheqjen e diplomës janë të pasqyruara në rregulloren e programit të studimit (evidence H1).</p> <p>Këto praktika propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore (evidence 2.2) duke ruajtur një raport jo më të madh se 20 studentë për një personel akademik. Praktikrat zhvillohen në bashkëpunim me biznese dhe institucione partnere bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit të siguruara nga IAL (tabela përmbledhëse 5).</p> <p>Studentët e vitit të fundit informohen për programin e temave të diplomave brenda muajit të parë të vitit akademik dhe drejtohen nga personel akademik i kategorive lektor dhe professor (evidence 4.4). Këto punime janë prezantuar edhe në konferencat studentore të organizuara nga AU në bashkëpunim me IAL të tjera partnere. (evidencë 3.8)</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli akademik mbikqyrës ka detyrën e monitorimit të zhvillimit të praktikës mësimore në mënyrë korrekte nga ana e studentëve në institucionin përkatës ku janë caktuar si dhe të ndihmojë studentët në varësi duke i udhëzuar në lidhje me hartimin e dokumentacionit të raportimit të praktikës së zhvilluar nga ana e tyre.</p> <p>Raporti përfundimtar i studentit duhet të miratohet paraprakisht nga personeli akademik mbikqyrës përpara se të mbrohet përpara komisionit ad-hoc të ngritur nga njësia bazë (evidencë H1).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>AU ka një procedurë transparente për përzgjedhjen e personelit akademik por pavarësisht thirrjeve për rekrutim të personelit akademik efektiv. Njësia bazë / kryesore nuk ka arritur që të përmbushë rekomandimet e akreditimit të kaluar për shtimin e personelit akademik të kategorisë lektor / professor.</i></p>

	<p><i>Kjo situatë sjell një mbingarkesë të lartë për personelin akademik të angazhuar në programin e ciklit të dytë përsa i përket orëve në auditor si dhe një numër të lartë modulesh të ndryshme të mbuluara gjatë një viti akademik që është në mospërputhje me standardet e cilësisë. Gjithashtu ngarkesa PAE-PAK është në limitet 70%-30%.</i></p> <p><i>Rekomandim: Duhet të shtohet numri i personelit akademik efektiv i kategorisë lektor / professor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Aktiviteti mësimor për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ku bën pjesë edhe Departamenti i Inxhinierive përgjegjës për programin e studimit master i shkencave në “Teknologji Informacioni” e zhvillon mësimin në një godinë të dedikuar për këtë njësi kryesore (evidence 4.5). Kjo godinë ofron ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në përputhje me natyrën e programit të studimit (tabela përmbledhëse 16). Këto ambiente përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 salla për leksione; - 7 salla për seminare; - 8 laboratorë, dy prej të cilëve janë laboratorë informatike;
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit</p>	<p>Nga vizita e GVJ u evidentua se mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për mundësimin e ofrimit të mësimin në mënyrë bashkëkohore nga ana e personelit akademik.</p> <p>Ambjetet ofrojnë internet wireless, videoprojektor, PC etj. (evidence 1.5)</p>

<p>mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Godina përmban 6 laboratorë për lëndë specifike profesionale, 2 laboratorë informatike, 5 salla leksioni, 7 salla për seminarët si dhe mjediset e tjera për zhvillimin teorik dhe praktik të moduleve të programit të studimit bachelor në Teknologji Informacioni (tabela përmbledhëse 16).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në mesin e procesit të zhvillimit të programit të studimit ka 2 laboratorë informatike, njëri prej të cilëve janë instaluar edhe pajisje për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike (evidencë 1.5).</p> <p>Këta laboratorë përmbajnë software të përshtatshëm dhe njësi të mjaftueshme për zhvillimin e orëve laboratorike.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e</p>	<p>AU garanton ambiente dhe laboratorë të përshtatshëm për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe i mundëson studentëve edhe zhvillimin e praktikave profesionale në ambientet e institucioneve partnere bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi si dhe në përputhje me kërkesat e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni". (Evidencë 1.5, 1.7, 2.2, tabelë përmbledhëse 5).</p>

programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>AU vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë e detyrueshme për modulet e programit të studimit është e pasqyruar në syllabuset e lëndëve (evidence 2.1d, 4.6) dhe biblioteka zotëron kopje fizike të kësaj literature që vihet në dispozicion të studentëve. Gjithashtu studentët dhe personeli akademik kanë akses në library të ndryshme online për literaturë plotësuese në formatin elektronik (tabelë përmbledhëse 17).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në përfundim të çdo viti akademik, personeli akademik propozon dhe miraton ndryshimet në syllabuset e lëndëve përkatëse. Në këto ndryshime pasqyrohet edhe përditësimi dhe pasurimi i literaturës së detyrueshme dhe të këshilluar nga ana e personelit akademik. Ky informacion kërkohet çdo vit nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe hartohet nga përgjegjësi i njësisë bazë (evidence 2.7). Nga ana tjetër, çdo fillim viti akademik, bazuar në kërkesat e personelit akademik, departamenti bën kërkesë për pasurimin e literaturës së bibliotekës. Nga evidencat e ofruara nga IAL, Departamenti i Inxhinierive ka bërë kërkesë për pasurimin e

	literaturës fizike vetëm gjatë vitit akademik 2021-2022 (evidencë 2.8).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka mësimore është në dispozicion të studentëve çdo ditë jave si dhe edhe me orare të kufizuara edhe në fundjavë duke ofruar përveç literaturës fizike edhe 25 njësi kompjuterike të lidhura me internetin dhe libraritë online.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka përmban një literaturë fizike me mbi 120 tituj librash (evidencë 4.6) që mbulon mbi 80% të literaturës së detyruar të pasqyruar në syllabuset e lëndëve (evidencë 2.1b). E mbështetur edhe me literaturën në format elektronik që është pjesë e librarive online, biblioteka mbështet studentët dhe personelin akademik me materialet e nevojshme didaktike për zhvillimin e moduleve të programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik janë edhe librari online (tabela përmbledhëse 17) të cilat janë të aksesueshme në ambjentet e bibliotekës.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka përmban 25 njësi pune (PC) që janë në dispozicion të studentëve çdo ditë jave gjatë orarit të zhvillimit të mësimi (8:00-16:00) si dhe me orare të kufizuara gjatë ditës së shtunë (8:00-12:00). Këto njësi pune zotërojnë programet e nevojshme për aksesimin e librarive online të mundësuar nga IAL.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit	Përveç orarit zyrtar (8:00-16:00), biblioteka qëndron e hapur edhe jashtë këtyre orareve në rastet kur ka mësim pasdite për programet e ciklit të dytë (16:00-20:00) si dhe ditën e shtunë në orarin (8:00-12:00).

<p>mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>				
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Njësia bazë dhe personeli përgjegjës për bibliotekën mësimore bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për tu informuar në lidhje me shfrytëzimin e fondit të bibliotekës nga ana e studentëve dhe personelit akademik si dhe për përditësimin dhe pasurimin e vazhdueshëm të literaturës bazuar në kërkesat e tyre.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia kryesore disponon një bibliotekë fizike e cila në rast nevojë funksionon edhe gjatë fundjavës dhe pasdite. Gjithashtu në shërbim të personelit akademik dhe studentëve janë edhe disa biblioteka online.</i></p> <p><i>Krahasuar me periudhën e akreditimit të kaluar ka përmirësim në procedurat dhe pasurimin e bibliotekës me literaturë të nevojshme për këtë program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e të dhënave të studentëve është sekretaria mësimore (evidencë 4.7) e cila disponon regjistrat fizikë me të dhënat e studentëve si dhe menaxhon edhe të dhënat elektronike në lidhje me ecurinë akademike të studentëve nëpërmjet sistemit Pitagora.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Të dhënat për personelin akademik, ndihmës akademi dhe administrativ administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse për administrimin dhe përditësimin e dosjes së çdo punonjësi të IAL.</p> <p>Të dhënat për partnerët e angazhuar në realizimin e programit administrohen nga njësia bazë që mbulon programin e studimit, si dhe në varësi të rolit të partnerit edhe nga zyra të tjera si Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë etj.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët, personeli akademik dhe sekretaria mësimore kanë llogarinë e tyre personale në sistemin online ku aksesojnë të dhënat e tyre si dhe ruajnë / aksesojnë informacioni e arritjeve akademike të studentëve në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në mungesë të një platforma të integruar komunikimi interaktiv në sistemin Pitagora, personeli akademik dhe studentët komunikojnë me anë të platformave alternative si Microsoft Teams ose me anë të emaileve zyrtare që ata zotërojnë.</p>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të arritjeve akademike të studentëve.</p> <p>Raportimet hartohen nga administrata, sekretaria mësimore ose njësia bazë në varësi të kërkesave të organeve dhe autoriteteve drejtuese të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet në lidhje me programin e studimit janë të publikuara në faqen zyrtare elektronike të IAL (albanianuniversity.edu.al) në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Gjithashtu është duke u punuar edhe në ofrimin e informacionit në gjuhën italiane.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të</p>	<p>AU është pjesë e Shoqërisë UFO shpk, dhe këtij institucioni, bazuar në një program afatmesëm tre vjeçar, i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat përkatëse bazuar në legjislacionin në fuqi. Kriteret e hartimit të buxhetit dhe shpërndarja e tij vendosen nga Bordi i Administrimit dhe hartimi i tij bëhet nga administrator/ët mbështetur në nevojat e paraqitura nga njësitë</p>

studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	bazë / kryesore. Buxheti miratohet paraprakisht në Senatin Akademik dhe më vonë nga Bordi i Administrimit.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Shpenzimet për veprimtarinë mësimore kanë peshën më të madhe në buxhet dhe ato përfshijnë edhe pagat dhe kontributet e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Në funksion të këtij programi studimi gjatë periudhës së fundit 5 vjeçare është investuar në mënyrë të vazhdueshme në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës mësimore (laboratorët e informatikës), pasurimin e literaturës (evidencë 2.8), zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore etj.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	AU në strukturën e tij ka edhe Zyrën e Auditit të Brendshëm që është njësi administrative përgjegjëse edhe për monitorimin e aktivitetit të Zyrës së Financës. Gjithashtu çdo vit realizohet edhe auditi vjetor nga një kontabël i miratuar që harton një pasqyrë financiare të detajuar ku analizohet efektiviteti i përdorimit të të ardhurave nga ana e IAL. Rezultatet e auditimit raportohen pranë Bordit të Administrimit.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Njësia bazë / kryesore ka përfaqësuesit e saj në Senatin Akademik dhe në rektorat ku raportohet dhe diskutohet në lidhje me buxhetin. Gjithashtu hartimi i buxhetit vjen si rezultat i kërkesave dhe nevojave të paraqitura nga njësia bazë.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e	Situata financiare e AU ka treguar qëndrueshmëri përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit (tabela përmbledhëse 18) ku

<p>programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>vazhdimisht është investuar në përmirësimin e infrastrukturës mësimore në dispozicion të këtij programi studimi.</p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në</p>	<p>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga regjistrimi i tyre dhe deri në diplomim. Këto procedura janë të pasqyruara në rregulloret e brendshme të IAL, njësisë bazë / kryesore dhe në rregulloren e programit të studimit. (evidencë 1.3, 1.6, 2.3, 2.5, 4.7, H1)</p>

fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Çdo kandidat që plotëson kërkesat ligjore ka të drejtë të aplikojë dhe të regjistrohet në këtë program studimi nëse renditet si fitues. Gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre janë të pasqyruara qartë në rregulloret e brendshme të IAL duke siguruar transparencë dhe barazi për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit. (evidencë 1.3, 1.6, 2.3, 2.5, 4.7, H1) Renditja e kandidatëve fitues publikohet në faqen zyrtare të IAL dhe çdo kandidat ka të drejtën e ankimit në rast kur konstaton parregullsi.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë master i shkencave në Teknologji Informacioni është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në të njëjtin profil ose programe të ngjashme që kanë jo më pak se 60% ngjashmëri me programin bachelor në "Teknologji Informacioni". (evidencë 2.5) Për të fituar të drejtën e aplikimit në këtë program studimi zbatohen kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, vlerësimi i dijeve si dhe procedurat e diplomimit janë pasqyruara në Rregulloren e Programit të Studimit (evidencë H1). Informacionet në lidhje me njohjen e plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme janë pjesë e Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve (evidencë 2.5). Këto informacione vihen në dispozicion të studentëve me kërkesë të tyre dhe gjatë regjistrimit të tyre në IAL.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informimi i publikut në lidhje me kërkesat dhe kriteret e programit të studimit bëhet nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të AU, si dhe me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë që njësi bazë organizon çdo fund viti akademik me studentët që diplomohen në programet e studimit bachelor.

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në kuotat e miratuara për programin e studimit parashikohen edhe kuota të dedikuara për kategori të veçanta ku në vitin e kaluar akademik ishin parashikuar kuota për studentë me statusin e jetimit, persona me aftësi ndryshe, komunitetin rom dhe ballkano-egjiptian si dhe për trojet. Këto kuota përcaktohen nga Senati Akademik.			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Miratimi i kriterëve dhe kuotave për kandidat nga shtete të tjera bëhet çdo fillim viti akademik nga ana e Senatit Akademik.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	AU ofron mbështetje dhe bursa për studentët me rezultate të larta që janë pjesë e programit të ekselencës si dhe për kategori të veçanta bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe vendimet e Senatit Akademik të IAL.			
Konkluzione	<i>AU ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat

Në momentin e regjistrimit, studentët informohen me rregulloren e programit të studimit (evidencë H1) ku pasqyrohen kriteret për

<p>e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>përparimin e tyre akademik gjatë kohëzgjatjes së periudhës së studimit.</p> <p>Për të kaluar në vitin pasardhës akademik, studenti duhet të ketë rezultate kaluese në të paktën 50% të lëndëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve (evidencë 2.5), Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve në bashkëpunim të ngushtë me njësinë bazë informon studentët e interesuar në lidhje me transferimin e studimeve apo krediteve nga periudha të mëparshme studimi.</p> <p>Informimi, pranimi i dokumentacionit për aplikim si dhe ndjekja e procedurave administrative bëhet nga Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve. Dosja e aplikimit i përcillet njësisë bazë e cila miraton kreditet dhe lëndët e njohura dhe i përcjell ZTES vendimin dhe praktikën e ndjekur.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të vitit akademik, studentët informohen në lidhje me mënyrën e funksionimit të aktiviteteve mësimore në IAL, infrastrukturën, rregulloret e brendshme në përgjithësi dhe rregulloren e programit të studimit në veçanti. Për informimin e studentëve angazhohen strukturat përgjegjëse ku përfshihen personeli akademik i njësisë bazë, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Këshilli Studentor etj.</p> <p>Gjithashtu javën e parë të mësimin, personeli akademik i lëndës informon studentët në lidhje me programin mësimor (syllabusin) e lëndës duke përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Procesi i diplomimit realizohet me anë të mbrojtjes së një teze diplome (evidencë H1).</p> <p>Gjatë muajit të parë të vitit akademik, drejtuesi i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit informon studentët në lidhje me programin e temave të diplomës (evidencë 3.5).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e</p>	<p>Informimi i çdo kandidati të interesuar për informacione më të detajuara bëhet pranë IAL nga zyrat e informacionit si dhe nëpërmjet faqes zyrtare elektronike dhe mjeteve të tjera të komunikimit që IAL vendos në dispozicion.</p> <p>Gjithashtu njësisia bazë organizon çdo fund viti akademik me studentët që diplomohen në programet e studimit bachelor.</p>

studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.				
Konkluzione	<i>Njësia bazë / kryesore disponon informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik të studentëve.</i> <i>Strukturat përkatëse kryejnë takime informuese çdo fillim viti akademik dhe duke krijuar kontakte dhe duke ruajtur komunikimin gjatë vitit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë javës së parë të vitit akademik, IAL organizon ditët orientuese ku studentët informohen në mënyrë të detajuar në lidhje me mënyrën e funksionimit të aktiviteteve mësimore në IAL, infrastrukturën, rregulloret e brendshme në përgjithësi dhe rregulloren e programit të studimit në veçanti. Për informimin e studentëve angazhohen strukturat përgjegjëse ku përfshihen personeli akademik i njësisë bazë, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Këshilli Studentor etj.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë ditëve të informimit studentët njihen me përmbajtjen e programit të studimit (evidencë 2.1) dhe në fillim të çdo semestri studentët informohen nga personeli akademik i lëndës në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, mënyrën e vlerësimit, literaturën e kërkuar etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni janë përgjegjëse për informimin e studentëve në lidhje me mundësitë e punësimit apo të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme orientuese apo këshilluese (evidencë 5.1).

orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Këto struktura mbështesin studentët në aplikimet e tyre për mundësi punësimi në kompani partnere me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi (evidencë 5.2).			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor mund të aksesohet nga studentët nëpërmjet sistemit Pitagora ose në komunikim me sekretarinë mësimore. Në lidhje me aktivitetet ekstrakurrikulare studentët informohen nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të IAL, me anë të emaileve zyrtare ose nëpërmjet personelit akademik ose zyrave përgjegjëse për komunikimin me studentët.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi Pitagora mundëson që studentët të kenë informacion të përditësuar në lidhje me programin e studimit, orarin mësimor, rezultatet e arritjeve akademike etj. Ky sistem aksesohet nga studentët me anë të llogarisë që ata hapin në momentin e regjistrimit si student deri në momentin që ata diplomohen.			
Konkluzione	<i>Faqja zyrtare elektronike e AU, sistemi i menaxhimit Pitagora, përdorimi i platformës Microsoft Teams ofrojnë për studentët informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të	Institucioni administron statistikat për studentët e diplomuar në programin e studimit. Këto të dhëna përditësohen dhe ruhen nga sekretaria mësimore dhe njësi bazë / kryesore përgjegjëse për programin e studimit. (tabela përmbledhëse 23)

diplomuarve, në programin e studimit.																	
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat për studentët e regjistruar, çrregjistruar, diplomuar apo transferuar ruhen dhe përditësohen nga sekretaria mësimore si dhe pasqyrohen në raportet e njësisë bazë / kryesore përgjegjëse për programin e studimit (evidencë 1.1, tabela përmbledhëse 21, 23).</p> <table border="1" data-bbox="611 555 1385 831"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të transferuar</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>19</td> <td>0</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>30</td> <td>0</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>22</td> <td>1</td> <td>23</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të transferuar	Total	2020-2021	19	0	19	2021-2022	30	0	30	2022-2023	22	1	23
Viti akademik	Të regjistruar	Të transferuar	Total														
2020-2021	19	0	19														
2021-2022	30	0	30														
2022-2023	22	1	23														
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave statistikore është sekretaria mësimore e cila raporton në autoritetet apo organet drejtuese të IAL.</p>																
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e informacionit dhe dokumentacionit të studentëve dhe të veprimtarisë së tyre akademike është sekretaria mësimore. Ajo është përgjegjëse për mirëmbajtjen e të dhënave të regjistrimeve, transferimeve, provimeve, diplomimeve, regjistrimit të studentëve dhe të arritjeve akademike. (evidencë 4.7)</p> <p>Përveç kontrolleve që kryen kryesekretari i njësisë kryesore, AU përcakton në aktet e brendshme rregullatore mundësinë e ushtrimit të kontrolleve periodike për saktësinë e informacionit në lidhje me studentët. Këto kontrolle mund të bëhen me kërkesë të drejtuesit të njësisë kryesore, rektoratit ose Zyrës së Kontrollit dhe Auditit të Brendshëm. (evidencë 1.2, 1.3)</p> <p>Gjatë kontrollit të ushtruar nga GVJ në sekretarinë mësimore, të dhënat për studentët e këtij programi studimi të përzgjedhur rastësisht ishin të plotësuara saktë dhe të dhënat e arritjeve të tyre</p>																

	akademike ishin në përputhje me procesverbalët e zotëruar nga sekretaria mësimore.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në përfundim të vitit akademik, njësia bazë në raportin vjetor pasqyron edhe të dhënat analitike për studentët e programit të studimit, cilësinë e tyre në hyrje dhe në përfundim të studimeve etj. së bashku me rekomandime për marrjen e masave kur shikohet e arsyeshme. (evidencë 1.1)			
Konkluzione	<i>Njësia bazë dhe sekretaria mësimore, administrojnë, përditësojnë dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Këshillin Studentor ku zgjidhet edhe kryetari i këtij këshilli. Kryetari i Këshillit Studentor është edhe përfaqësues i studentëve në Senatën Akademik të AU (evidencë 1.2).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në	Përfaqësimi dhe përfshirja e studentëve në vendimmarrje pasqyrohet edhe me përfaqësimin e tyre në mbledhjet e njësive

vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	bazë (evidencë 5.3), në grupet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimit (evidencë H2) etj.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Institucioni ruan një komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe përfaqësuesit e tyre duke vlerësuar mendimin e tyre edhe në lidhje me programin e studimit. Ky komunikim vjen nga propozimet e Këshillit Studentor, pyetësorët periodik që zhvillohen në lidhje me cilësinë e mësimdhënies etj. (evidencë 6.9)			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të drejtë të njihen me pikët dhe vlerësimin dhe në rast se konstaton parregullsi atëhere mund ta ankimoj rezultatin brenda 48 orëve me anë të një kërkesë me shkrim që depozitohet pranë sekretarisë mësimore (evidencë H1).			
Konkluzione	<i>Studentët me përfaqësuesit e tyre angazhohen në Senatin Akademik, asamblenë e njësisë bazë si dhe në organet këshilluese si Këshilli Studentor, komisionet e Sigurimit të Cilësisë etj., në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Njësia bazë dhe sekretaria mësimore janë strukturat kryesore përgjegjëse për informimin e studentëve. Njësitë e tjera përgjegjëse janë Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (evidencë 5.4) dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit (evidencë 5.5).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Orientimi dhe këshillimi i studentëve fillon në momentin e regjistrimit të tyre gjatë javës së orientimit. Gjatë kohëzgjatjes së studimeve departamenti i cakton çdo studentin një personel akademik kujdestar (mentorim) i cili është pikë orientimi për studentin për çdo paqartësi apo problematikë që mund të hasë gjatë kohëzgjatjes së studimeve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni janë përgjegjëse për informimin e studentëve në lidhje me mundësitë e punësimit apo të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme orientuese apo këshilluese (evidencë 5.1). Këto struktura mbështesin studentët në aplikimet e tyre për mundësi punësimi në kompani partnere me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi (evidencë 5.2, tabelë përmbledhëse 5).
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas	Zyra e Karrierës dhe Alumnit në mënyrë periodike përditëson të dhënat mbi punësimin e studentëve të diplomuar nëpërmjet

diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	pyetësorëve periodik dhe ia raporton rezultatet autoriteteve drejtuese të IAL. Mënyra e përzgjedhur për grumbullimin e informacionit për punësimin e studentëve është nëpërmjet një pyetësi online (evidencë 6) drejtuar studentëve të diplomuar. Bazuar në informacionin e ofruar nga IAL (tabelë përmbledhëse 23), nga 84 studentë të diplomuar në këtë program studimi për periudhën 2018-2023, 53 studentë (63%) i janë përgjigjur pyetësorit dhe nga përgjigjet e përfuara 79% janë të punësuar në përputhje me programin e studimit.			
Konkluzione	<i>AU ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Institucioni ka mundësuar për personelin akademik përdorimin e platformës Microsoft Teams për komunikimin interaktiv me studentët dhe mundësimin të shpërndarjes së materialeve mësimore (evidencë 3.2). Për këtë qëllim janë zhvilluar disa trajnime dhe janë hartuar udhëzues për personelin akademik dhe studentët për përdorimin e instrumentave informatik në funksion të procesit të mësimdhënies (evidencë 3.4).

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Vlerësimi periodik i cilësisë së mësimdhënies të personelit akademik realizohet nëpërmjet pyetësorëve semestral që studentët plotësojnë për vlerësimin e personelit akademik (evidencë 3.3). Strukturat përgjegjëse për monitorimin e këtij procesi janë njësia bazë, NJSBC, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave (evidencë 1.3). Gjatë komunikimit që GVJ zhvilloi me personelin akademik dhe studentët sugjerohet që ky pyetësor të zgjerohet me pyetje më të detajuara për elementët që ndikojnë në kënaqësinë apo pakënaqësinë e studentëve në lidhje me procesin mësimor.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në fund të çdo semestri, përpara sezonit të provimeve, studentëve u kërkohet të plotësojnë pyetësorin për vlerësimin e personelit akademik (evidencë 3.3). Pjesëmarrja e studentëve në plotësimin e këtij pyetësori është e ulët dhe për këtë arsye sugjerohet që të rishikohet mënyra e shpërndarjes së pyetësorit te studentët ose të zhvillohen takime informuese për të rritur motivimin e studentëve për të qënë më aktiv në përfshirjen e tyre në këtë proces.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pas përpunimit të të dhënave nga NJSBC, informacioni i përfutur vihet në dispozicion të njësisë bazë dhe çdo lektor informohet për rezultatet e tij individuale. Kur shikohet e arsyeshme këto rezultate diskutohen dhe analizohen në organet kolegjiale përkatëse nga njësia bazë deri në Senatin Akademik.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pyetësori për studentët (evidencë 3.3) për cilësinë e mësimdhënies përmban vlerësimin e studentëve për: - lëndët që kanë zhvilluar mësim gjatë semestrit / vitit akademik - personelin akademik që ka zhvilluar mësimin - infrastrukturën - personelin administrativ Bazuar në rezultatet e përfutura nga këto pyetësorë, drejtuesi i njësisë bazë identifikon problematikat e mundshme nëse ka dhe aspektet që mund të përmirësohen në funksion të mësimdhënies.
Konkluzione	<i>Garantimi dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies në AU sigurohet kryesisht nëpërmjet pyetësorit të studentëve dhe vlerësimit të rezultateve që dalin nga ky pyetësor.</i>

	<p><i>Nga dokumentacioni i dorëzuar nga GVB dhe nga vizita në terren u evidentua se ky pyetësor është kufizues në evidentimin e arsyeve që ndikojnë në përgjigjet e studentëve dhe se pjesëmarrja e studentëve në plotësimin e këtij pyetësori është shumë e ulët duke i bërë rezultatet e marra jopërfaqësuese</i></p> <p><u>Rekomandime:</u></p> <p><i>- Duhet riformatuar pyetësori i studentëve për cilësinë e mësimdhënies duke përfshirë pyetje më specifike</i></p> <p><i>- Duhet gjetur metoda për motivimin e studentëve që të marrin pjesë në mënyrë më aktive në dhënien e opinionit të tyre nëpërmjet këtij pyetësori</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	AU ka ngritur strukturat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë deri në nivelin e njësisë bazë si dhe ka hartuar politika në nivel institucional për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë. (evidencë 6.10)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm	Në nivel institucional Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur në AU që në vitin 2010 (evidencë 6.1) ndërkohë që në vitin 2016 u ngrit edhe Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin Institucional (evidencë 6.2) pjesë e të cilit është edhe një përfaqësues i studentëve. Studentët gjithashtu përfshihen në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për akreditimet e programeve të

<p>të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>studimit. Po në 2016 u ngritën edhe Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel njësie bazë (evidencë 6.3).</p> <p>Rëndësia që AU i kushton sigurimit të cilësisë theksohet edhe në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (evidencë 6.4). Në këtë proces AU angazhon edhe ekspert të jashtëm, më konkretisht një konsulent juridik dhe një konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave (evidencë 6.5).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sipas Vendimit të BA Nr.55, dt. 26.05.2023 për “akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Privat “Albanian University””, AU është akredituar me vlerësim përfundimtar pozitiv për një kohëzgjatje 4 vite. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit institucional është 25.05.2027.</p> <p>Programi i studimit master i shkencave në Teknologji Informatike është hapur me urdhër Nr. 33 të MAS, dt. 31.01.2012. Ky program studimi është akredituar për herë të parë me Vendim të BA Nr.169, dt. 16.05.2016 për një periudhë 6 muaj dhe riakredituar me Vendim të BA Nr.37, dt. 19.05.2017 për një periudhë 1 vit, dhe Vendim të BA Nr. 82, dt. 27.10.2018 për një periudhë 5 vite deri në 30.09.2023.</p> <p>Vlerësimi i jashtëm për qëllim akreditimit e këtij programi studimi po realizohet për herë të katërt.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Përmirësimi i programeve të studimit është një nga objektivat e përfshira në strategjinë e zhvillimit institucional (evidencë 1.4) si dhe në strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit (evidencë 6.4).</p> <p>Njësitë bazë, në përfundim të semestrit të parë dhe në fund të vitit akademik hartojnë raporte periodike (evidencë 1.1) ku pasqyrohen edhe analiza sasiore në lidhje me programet e studimit që njëzia mbulon, analiza SWOT së bashku me propozimet dhe masat e marra për përmirësimin e programit të studimit në të ardhmen.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, AU struktura institucionale, në nivel njësie kryesore si dhe në nivel njësie bazë. AU harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të këtyre strukturave.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Përveç strukturave në nivel institucional për sigurimin e cilësisë, AU ka ngritur edhe Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel njësie bazë (evidencë 6.3). Këto grupe përbëhen nga personel akademik efektiv dhe një nga objektivat kryesore kanë rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve në bashkëpunim me lektorët e lëndëve përkatëse. Anëtarët e GSC njëkohësisht angazhohen edhe si pjesë e GVB për akreditimet e programeve të studimit që mbulon njësia bazë.</p> <p>Procesi i sigurimit të cilësisë në AU përfshin disa aktor si GSC, njësinë bazë, njësinë kryesore, NJSBC etj. Në këtë proces përfshihen edhe anketimet e studentëve dhe personelit akademik në lidhje me faktorë të ndryshëm që ndikojnë në sigurimin e cilësisë (evidencë 6.7).</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve të NJSBC dokumentohen dhe u përcillen në formë shkresore të gjitha instancave përkatëse me qëllim marrjen e masave për përmirësim të mundshme në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe</p>	<p>Gjetjet e GSC dhe NJSBC përfshihen në raportet periodike të njësisë bazë / kryesore apo edhe në raportet institucionale. Këto raporte përmbajnë gjetjet, rezultate sasiore krahasuese, dhe masat e propozuara për tu marrë për përmirësimin e mangësive të identifikuara.</p>

<p>përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar RVB metodat e përdorura nga AU për monitorimin periodik të sigurimit të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësorët e studentëve të cilët realizohen të paktën 2 herë në vit (evidencë 3.3) • Fokus grupe (evidencë 6.8) • Raporte vetëvlerësimi për personelin akademik (evidencë 3.7) • Raport vetëvlerësimi i njësisë bazë (evidencë 1.1) etj. <p>Pjesë e metodave janë edhe analizimi i të dhënave sasiore për ecurinë akademike të studentëve si kalueshmëria, nota mesatare, rishikimi i programeve lëndore, rishikimi i kurikulës etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe</p>	<p>AU për mbarëvajtjen e programit të studimit, përveç komunikimit të drejtpërdrejtë, në raste specifike realizon anketime jo vetëm me studentët, por edhe me personelin akademik dhe personelin administrativ ku nga dokumentacioni mbështetës i ofruar si shembull është pasqyruar anketimi i këtyre kategorive për mësimin online gjatë vitit akademik 2019-2020 (evidencë 6.9).</p> <p>Institucioni përdor vlerësimin e tregut të punës si dhe intervistimin e studentëve të diplomuar (evidencë 6) si një metodë për të vlerësuar sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Ky vlerësim bëhet nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit.</p>

palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	
Konkluzione	<i>IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Si pjesë e procesit të sigurimit të cilësisë (evidencë 6.4), përveç personelit akademik dhe personelit administrativ të përfshirë në strukturat e ngritura nga AU për këtë qëllim, janë përfshirë edhe ekspertë të jashtëm si dhe marret opinioni edhe nga përfaqësues të bizneseve dhe institucioneve me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi. Strukturat e brendshme të SC janë: - Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel njësie bazë - Njësia Bazë (departamenti) - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Komisioni për Vlerësim Institucional - Rektorati - Senati Akademik
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Përbërja, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive që janë pjesë e procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC (evidencë 6.10). Kjo rregullore plotëson detyrat dhe përgjegjësitë që aktet e brendshme rregullatore caktojnë për autoritetet dhe organet drejtuese të IAL. Ajo fokusohet kryesisht te detajimi i rolit të

<p>ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Komisionit për Vlerësimin Institucional dhe Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në çdo akt rregullator të AU, rolin kryesor për vlerësimin e sigurimit të cilësisë për programin e studimit e ka njësia bazë dhe anëtarët e personelit akademik të kësaj njësie. Ata kanë përgjegjësinë kryesore në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për SC si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Pjesë e rëndësishme e këtij procesi janë edhe studentët në përfshirjen e tyre si pjesë e grupeve të punës dhe në plotësimin e pyetësorëve përkatës. Njësia kryesore monitoron dhe koordinon punën në nivel fakulteti.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Respektimi i integritetit akademik dhe të drejtave i të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë sigurohet edhe nga baza ligjore në fuqi si dhe nga aktet e brendshme rregullatore të AU, përfshirë edhe Kodin e Etikës (evidencë 6.11). Këto rregullore përcaktojnë edhe përfaqësimin e secilit aktor të brendshëm në strukturat e SC. Monitorimi dhe zbatimi i procedurave për sigurimin e cilësisë fillon nga njësia bazë dhe trajtohet në disa nivele deri në Senatin Akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit, AU angazhon edhe ekspertë të jashtëm nga fusha akademike ose e biznesit (evidencë 2.10) të cilët ofrojnë kontributin e tyre në lidhje me ndrysimin e kurrikulave dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p>Ndërkohë si pjesë e NJSBC AU ka angazhuar edhe ekspertë të jashtëm në rolin e konsulentit juridik dhe konsulentit për çështjet e zhvillimit dhe përmirësimin të kurrikulave (evidencë 6.5). Gjithashtu rëndësi i kushtohet edhe zbatimit të rekomandimeve të vlerësimit të ekspertëve të jashtëm gjatë procesit të akreditimit të programit të studimit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Struktura dhe organizimi institucional i AU është i pasqyruar në faqen elektronike zyrtare të IAL (https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/) ku Komisioni për Vlerësimin Institucional është pjesë e strukturës në varësi të Senatit Akademik, dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në varësi të rektoratit.</p> <p>Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore i dërgohet ministrisë përgjegjëse për arsimin sipas parashikimeve të akteve rregullatore në fuqi si dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të AU. Gjetjet e NJSBC i përcillen edhe organeve kolegjiale të cilat i diskutojnë me personelin akademik dhe studentë e njësisë përkatëse kur është e nevojshme ose me kërkesë të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Raporti vjetor i Departamentit të Inxhinierisë (evidencë 1.1) përmban të dhëna sasiore dhe cilësore për programin e studimit Msc në Teknologji Informacioni. Ky relacion i mundësohet anëtarëve të personelit akademik dhe autoriteteve dhe organeve drejtuese të IAL.</p> <p>Personat e interesuar për të aksesuar këtë informacion duhet të komunikojnë me kontaktet përkatëse që janë publike në faqen zyrtare të IAL në respekt të legjislacionit dhe politikave të privatësisë. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/)</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>	<p>Raporti vjetor i njësisë bazë përmban edhe masat e marra dhe një propozim për një plan veprimi për vitin e ardhshëm akademik sipas mangësive të identifikuara dhe fushave përkatëse. (evidencë 1.1)</p>

mangësive e dobësive të evidentuara.									
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Njësitë e sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet si dhe njësia bazë siguron dhe monitoron efektivitetin e veprimtarive në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Njësia bazë e pasqyron këtë vlerësim në raportin vjetor (evidencë 1.1) ndërkohë NJSBC monitoron çdo procedurë për ndryshimet në programin mësimor (evidencë 2.6) ose të programeve lëndore (evidencë 2.7).								
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Veprimtaritë informuese me studentët dhe personelin akademik zhvillohen gjatë javës së orientimit në fillim të vitit akademik si dhe në mbledhjet e asamblesë së personelit akademik të njësisë bazë ose njësisë kryesore. Në rastet e akreditimit të programeve të studimit, NJSBC organizon takime informuese dhe trajnuese me anëtarët e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm.								
Konkluzione	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe efektive, dhe kanë krijuar Kulturë të Brendshme të Cilësisë</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Albanian University tregon një qendrueshmëri financiare;
2. Albanian University ka një strukturë të konsoliduar për Sistemin e Sigurimit të Cilësisë deri në nivel njësie bazë;
3. Përveç sistemit Pitagora, Albanian University përdor sisteme komunikimi plotësuese në mbështetje të studentëve dhe personelit akademik si Microsoft Teams;

a. Pika të dobta:

1. Mosplotësim i rekomandimit nga akreditimi paraardhës, në lidhje me shtimin e stafit akademik efektiv të kategorisë “Profesor”, duke cuar në ngarkesën e lartë mësimore të stafit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi; *(Standardi IV.1, kriteret 1, 2 dhe 3)*
2. Formati i pyetësorit për perceptimin e studentëve për cilësinë e procesit mësimor dhe mospjesëmarrje aktive e studentëve në dhënien e përgjigjeve për pyetësorët e organizuar nga NJSBC; *(Standardi VI.1, kriteret 2 dhe 3)*

Rekomandime:

1. Institucioni të marrë masa për shtimin e personelit akademik me kohë të plotë të kategorisë “profesor”, me qëllim uljen dhe rishpërndarjen e ngarkesës mësimore të personelit akademik të angazhuar aktualisht në këtë program studimi;
2. Të riformatohet pyetësori i studentëve për cilësinë e mësimdhënies duke përfshirë pyetje më specifike ku të identifikohen arsyet e përgjigjeve të studentëve;
3. Të identifikohen metoda për motivimin e studentëve që të marrin pjesë në mënyrë më aktive në dhënien e opinionit të tyre nëpërmjet pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies;



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Information Technology"

a. Strengths and affirmations:

1. Albanian University shows a solid financial stability;
2. Albanian University has a consolidated structure for the Quality Assurance System down to the basic unit level;
3. In addition to the Pitagora system, AU uses additional communication systems to support students and academic staff such as Microsoft Teams;

b. Weaknesses:

1. Non-fulfillment of the recommendation from the previous accreditation, regarding the addition of the effective academic staff of the "Professor" category, leading to the high teaching load of the effective academic staff engaged in this study program; (*Standard IV.1, criteria 1, 2 and 3*)
2. Questionnaire format for students' perception of the quality of the learning process and non-active participation of students in answering the questionnaires organized by the Internal Quality Assurance Unit; (*Standard VI.2, criteria 2 and 3*)

Recommendation

1. The HEI should take measures to increase full-time academic personnel with at least a PHD degree, in order to reduce and redistribute the teaching load of the academic personnel currently engaged in this study program;
2. Need to reformat the students' questionnaire on the quality of teaching, including more specific questions to identify the reasons for the students' answers;
3. Need to identify methods for motivating students to participate more actively in giving their opinion through the questionnaire on the quality of teaching;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X